



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Raporti i Monitorimit të Prokurimit

Tetor 2023



Raporti i Monitorimit të Prokurimit

Aktiviteti i USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës

DEKLARATË MOHUESE: Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	6
Hyrje	7
Metodologjia e hulumtimit.....	8
1. Përmbledhje	10
2. Para-tenderimi.....	12
2.1. Kriteret diskriminuese	12
2.2. Përmbajtje e ndryshme e “dosjes së tenderit” dhe “njoftimit për kontratë”	14
2.3. Mungesa e projektit ekzekutiv	15
2.4. Tenderët e paplanifikuar	15
2.5. Shkurtimi i afateve për pranimin e tenderëve	16
2.6. Komisionet sekrete për hartimin e specifikacioneve teknike.....	18
2.7. Një operator një lot, mundësi për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme por kosto për komuna	20
3. Tenderimi.....	22
3.1. Vonesat në vlerësimin e ofertave	22
3.2. Referencat e dyshimta	23
4. Pas-tenderimi	25
4.1. Vonesa në realizim të punëve	25
4.2. Defektet në projektim.....	26
4.3. Loja me çmime të ulëta e produkte të panevojshme.....	27
4.4. Vit pas viti: Lidhja e kontratës me çmime abnormalisht të ulëta.....	28
5. Ankimimi.....	30
6. Ministria e Shëndetësisë	32
6.1. Mirëmbajtja e 70% të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh) - Faza e paratenderimit.....	32
Tenderi i vitit 2023	32
Bllokimi i tenderit në OSHP	34
Shkeljet në tenderin me një ofertues të përgjegjshëm.....	35
Sfidat me kontratën për furnizim me barna nga lista esenciale.....	36
Rekomandimet.....	38
Shtojca 1. Lista e tenderëve të analizuar.....	39

Lista e shkurtesave

AK	→	Autoriteti Kontraktues
AQP	→	Agjencia Qendrore e Prokurimit
KRRPP	→	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
KAB	→	Korniza Afatmesme Buxhetore
LPP	→	Ligji për Prokurimin Publik
NVM	→	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
MSH	→	Ministria e Shëndetësisë
OSHP	→	Organi Shqyrtues i Prokurimit
OE	→	Operator Ekonomik
PMK	→	Plani i Menaxhimit të Kontratës
QKUK	→	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
ZKA	→	Zyrtar Kryesor Administrativ
ZPP	→	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

Hyrje

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuose – (BIRN) dhe Demokraci Plus (D+), në kuadër të projektit “Mbështetja e OJQ-ve për të monitoruar aktivitetet e prokurimit në komuna dhe Ministri të Shëndetësisë”, të mbështetur nga aktiviteti i USAID-it Integriteti i Komunave të Kosovë, ka kryer monitorimin e 27 tenderëve. Ndër këta tenderë, tre prej tyre janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh).

Monitorimi është kryer në tri fazat kryesore: fazën e para-tenderimit, fazën e tenderimit, dhe fazën e pas tenderimit. Procesi i monitorimit ka përfshirë analizën dhe grumbullimin e dokumentacionit, inspektim në terren dhe diskutim me aktorët e rëndësishëm.

Raporti i monitorimit është përqendruar në gjetjet e bëra në 24 tenderë gjatë fazave të para-tenderimit, tenderimit, dhe pas tenderimit. Zbulimet e përbashkëta në disa tenderë janë grupuar nën tituj të veçantë për të përcaktuar nëse shkeljet janë sistematike dhe shpërndarë në më shumë se një tender apo komunë.

Tenderët e MSh-së janë trajtuar si raste të veçanta për studim, pasi ata kanë natyrë të ndryshme nga tenderët e komunave. Në këto tenderë janë identifikuar mangësitë në fazën e para-tenderimit, fazën e tenderimit, dhe fazën e pas tenderimit.

Metodologjia e hulumtimit

Gjatë periudhës implementuese për monitorimin e aktiviteteve të prokurimit në komunat e Fazës 1 të USAID KMI (Gjakovë, Gjilan, Lipjan, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Suharekë, Vushtrri) dhe në MSh, D+ dhe BIRN Kosova kanë vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse tërë procesin e prokurimit, për ta kuptuar në mënyrë të gjithanshme krejt performancën e prokurimit. Për ta arritur këtë, D+ dhe BIRN Kosova kanë përzgjedhur 27 aktivitete të prokurimit, bazuar në: vlerën financiare, analizën e vlerësimit të rrezikut dhe fazën e aktivitetit. Në mënyrë të veçantë, monitorimi është fokusuar në:

1 Procesin para tenderimit: Ky proces përfshin dizajnimin e detyrave, termat e referencës për tenderin, specifikimin e kriterëve teknike, dizajnin e projektit dhe më shumë, për nëntë tenderët (nga një në secilën komunë dhe Ministrinë e Shëndetësisë).

2 Procesin e tenderimit: Duke u fokusuar në performancën faktike të procesit të prokurimit për nëntë tenderët (nga një në secilën komunë dhe Ministrinë e Shëndetësisë).

3 Procesin pas tenderimit ose faza e menaxhimit të kontratës: Mbulimi i nëntë tenderëve (nga një në secilën komunë dhe Ministrinë e Shëndetësisë).

Përveç kësaj, D+ dhe BIRN Kosova kanë shqyrtuar indikatorët e mëposhtëm për t'i identifikuar problemet e mundshme në procedurat e tenderimit:

1 Afatet Vlerësimi i afateve të tenderit sipas kategorive të vlerave për të zbuluar flamujt e kuq (red flags) potencialë.

2 Shmangia e çmimit të kontratës (nëse vlera e kontratës është 40% ose më i lartë se vlera e përafërt): Vlerësimi i variacioneve të vlerës së kontratës nga vlerat e përafërta.

3 Një ofertues i vetëm: Hetimi i rasteve me vetëm një ofertues në procedura të hapura.

4 Afërsia e vlerës së kontratës: Analizimi se sa afër përputhen vlera e kontratës me vlerat e përafërta.

5 Çmimi jashtëzakonisht i ulët: Identifikimi i tenderëve ku vlerat e kontratës janë dukshëm më të ulëta se mesatarja e ofertave të tjera.

6 Fituesi është në listë të zezë: Verifikimi nëse kontratat u janë dhënë operatorëve ekonomikë që janë në listën e zezë.

7 Tenderi me çmim të ponderuar: Procedurat ekzaminuese ku sasi të artikujve përcaktohen në 1 për secilin artikull.

Kjo qasje gjithëpërfshirëse synon të ngrisë në shkallë më të lartë transparencën dhe llogaridhënien në proceset e prokurimit nëpër komunat e lartcekura dhe në MSh. Lista e tenderëve të monitoruar është bashkangjitur si Shtojcë në fund të këtij raporti.

1

Procesi para tenderimit

Në fazën para tenderimit, ekipi ynë i projektit ka shqyrtuar nga afër aspektet kryesore, përfshirë: Përshtatjen e planit të prokurimit; Prokurimet që nuk janë të përfshira në plan; Konsistencën e të dhënave; Specifikimet teknike; Pajtueshmërinë me standardet; Burimin e produktit; Markat e specifikuara; Produktet e patentuara dhe Lidhjet biznesore-politike.

2

Procesi i tenderimit

Në fazën e tenderimit, ekipi ynë ka monitoruar dhe vlerësuar nga afër aspekte të ndryshme shumë të rëndësishme, përfshirë: Përbërjen e Komisionit Vlerësues; Sfondin profesional; Konfliktin e interesit; Lidhjet me figura me ndikim; Konkurrencën; Respektimin e afatit; Pajtueshmërinë me kriteret e çmimeve; Tenderin ekonomikisht më të favorshëm (TEMF); Trajtimin e ankesave; Ofertuesit e tërhequr; Flamuj të tjerë të kuq; Integritetin e raportit të vlerësimit; Vendimet e zyrtarit kryesor të prokurimit; Historinë e biznesit dhe lidhjet, dhe Ankesat që lidhen me vlerësimin.

3

Procesi pas tenderimit ose faza e menaxhimit të kontratës

Në fazën e pas tenderimit ose të menaxhimit të kontratës, vëmendja është përqendruar në mbikëqyrjen e aktiviteteve të menaxhimit të kontratave për nëntë tenderët (nga një në secilën komunë dhe Ministrinë e Shëndetësisë). Menaxhimi i kontratës është një element kulminant i procesit të prokurimit, ku theksohet nevoja që projekti të kuptohet në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse dhe të ketë komunikim efektiv me menaxherin e kontratës përgjegjës për çdo segment të kontratës.

Rrjedhimisht, në përpjekjet tona monitoruese janë përfshirë kërkimi i dokumenteve qenësore, si: Emërimi i menaxherit të projektit; Plani i menaxhimit të kontratës; Verifikimi nëse plani i menaxhimit është publikuar në platformën e prokurimit elektronik; Të gjitha komunikimet ndërmjet menaxherit të kontratës, operatorëve ekonomikë (OE) dhe Autoritetit Kontraktues (AK); Dokumentacioni i ditarit të punës së menaxherit të projektit; Frekuenca (shpeshtësia) e vizitave në terren të kryera nga menaxheri i kontratës; Të gjitha raportet e ecurisë së projektit; Raportet ose kërkesat që menaxheri i kontratës ia ka drejtuar AK-së ose Zyrës së Prokurimit; Procesverbali i takimit që lidhet me menaxhimin e kontratës; Dokumentacioni që konfirmon pranimin e furnizimeve, të shërbimeve ose të punimeve; Hetimi i vonesave të hasura në zbatim, nëse ka të tilla; Verifikimi i pagesave të kryera nga AK-të dhe kopjet e të gjitha faturave për punë. Po ashtu, monitoruesit do të kryejnë vizita në terren për të vlerësuar ecurinë e punës në vend të ngjarjes.

1. Përmbledhje

Komunat dhe MSh vazhdojnë të kenë sfida për të përmbyllur një proces të prokurimit pa shkelje të Ligjit dhe Rregullave të Prokurimit Publike. Që nga faza e parë e planifikimit të prokurimit e deri në menaxhimin dhe zbatimin e plotë të një kontrate janë evidentuar shkelje. Disa prej shkeljeve janë të izoluar, mirëpo ka edhe të tilla që janë të shpërndara në pjesën më të madhe të Autoriteteve Kontraktuese (AK) që janë monitoruar.

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulmuese (BIRN) dhe Demokraci Plus (D+) kanë monitoruar 27 tenderë në kuadër të projektit “Mbështetja e OJQ-ve për të monitoruar aktivitetet e prokurimit në komuna dhe MSh-së”, të mbështetur nga aktiviteti për Integritet në Komuna i USAID. Tre nga 27 tenderët e monitoruar kanë qenë të MSh-së. Monitorimi ka qenë i përqendruar në tri faza, fazën e para-tenderimit, tenderimit dhe pas tenderimit. Ndërsa procesi i monitorimit ka përfshirë mbledhjen dhe analizimin e dokumentacionit, vizita në terren dhe takime me akterët relevantë.

Një prej shkeljeve më të shpeshta që është evidentuar gjatë këtij monitorimi ka qenë vendosja e kriterëve diskriminues, kriterëve shumë të larta për projektin apo emërimi i produkteve dhe prodhuesve që janë kërkuar. Nga nëntë tenderët që janë monitoruar në fazën e para-tenderimit, vetëm njëri prej tyre nuk ka pasur asnjë korrigjim të gabimeve në njoftime, përkatësisht kriteret teknike apo profesionale. Në tetë prej tenderëve të monitoruar, të paktën një herë ka pasur korrigjime të gabimeve përmes formularëve për korrigjim të gabimeve (B54). Në dy raste janë bërë nga gjashtë korrigjime të njoftimeve, kryesisht kishte ulje të kriterëve teknike apo profesionale, vetëm pasi ishin bërë ankesa nga Operatorë Ekonomik (OE).

Vendosja e kriterëve diskriminues ka bërë që disa prej tenderëve të anulohen tërësisht, apo të pranohet vetëm një ofertë e përgjegjshme edhe për tenderë të

zakonshëm në Kosovë, siç është zgjerimi apo asfaltimi i rrugëve. MSh, për shkak të kompleksitetit dhe natyrës së punës, kishte telashe të përmbyllte dy nga tenderët e monitoruar. Tenderi i MSh-së - “Mirëmbajtja e 70% të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh)”¹ ishte anuluar edhe pse ishte rekomanduar për kontratë e vetmja kompani që kishte aplikuar. Një raport i ekspertëve të Bankës Botërore kishte nxjerrë në pah kriteret diskriminuese që kishin ndikuar që nga 49 OE-të të interesuar për projektin në fjalë në fund të dorëzohej vetëm një ofertë. MSh kishte telashe të përmbyllte edhe procesin tjetër të prokurimit - “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”². Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka vendosur që të anulojë vendimin e MSh-së për dhënie të kontratës, duke e kthyer tenderin në rivlerësim.

Secili AK, në publikimin e aktivitetit të prokurimit publik është i obliguar të lë një periudhë kohore për pranimin e ofertave nga OE-të. Afatet kohore minimale që secili AK duhet t'i zbatojë janë të parapara me ligj. Afatet dallojnë në bazë të vlerave të parashikuara të kontratës. Por, me ligj dhe rregulla të prokurimit është lënë mundësia që të shkurtohen afatet e pranimi të ofertave në raste të caktuara. Gjatë monitorimit janë evidentuar raste kur komunat kanë shkurtuar afatet në kundërshtim me kërkesat ligjore. Shkurtimi i afateve mund të ndikojë në pjesëmarrje të ofertuesve. Komunat në njërin anë bëjnë shkurtime të afateve për pranimi të ofertave, e në anën tjetër e zvarrisin procesin e vlerësimit të ofertave, në disa raste edhe përtej limiteve ligjore.

Një prej hallkave më të rëndësishme në prokurim publik është hartimi i specifikacioneve teknike dhe profesionale për një projekt. Shpeshherë, caktimi i specifikacioneve teknike mund të paracakttojë fituesin e një tenderi. Komunat e monitoruara në masë të madhe nuk kanë qenë në gjendje të tregojnë emrat e personave që i kanë hartuar specifikacionet teknike

1 Tenderi “[Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore](#)”, Nr. prokurimit: 206-23-1650-2-1-1

2 Tenderi “[Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit, BHIS”](#)”, Nr. prokurimit:206-23-571-2-1-1

për një projekt. Kryesisht, emrat e personave që i caktojnë rregullat e lojës për një tender janë mbajtur sekret nga komunat. Vetëm MSh ka treguar emrat e personave që i kanë hartuar specifikacionet teknike për tre nga tenderët e monitoruar. Kjo e fundit ka filluar një praktikë³ që anëtarët e Komisionit për hartim të specifikave e nënshkruajnë një deklaratë nën betim, që thotë se janë të vetëdijshëm për rëndësinë e punës që e bëjnë dhe e njëjtat nuk është bërë për të favorizuar ndonjë kompani apo prodhues.

Gjatë monitorimit të 27 tenderëve janë hasur raste kur për shkak të rregullave të tenderit të vendosura qysh në fillim është dëmtuar buxheti i komunës. Kemi gjetur se një tender i shpallur me shumë lloje dhe që ishte kufizuar që një OE mund të fitojë vetëm një llot për kontratë, kishte qar në rekomandim të OE-të që nuk ishin me ofertat më të lira të përgjegjshme.

Përkundër avancimit të procesit të vlerësimit të ofertave, prapë kjo fazë është ndër më të atakuarat nga OE-të duke i kontestuar vlerësimet që i kanë bërë AK në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Shkeljet më të shpeshta janë gjetur pikërisht gjatë fazës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Për 13 nga 27 tenderët e monitoruar apo në 48% prej tyre ka pasur ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Për këta 13 tenderë ishin bërë 32 ankesa në OSHP, prej të cilave 15 ishin refuzuar dhe në 13 prej tyre ishin aprovuar pretendimet e OE-vë ankues. Nga 13 vendime në të cilat OSHP-ja kishte gjetur shkelje ligjore, 12 prej tyre ishin shkelje të bëra gjatë fazës së ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve.

Faza e pas tenderimi është një tjetër proces shumë i rëndësishëm i prokurimit publik. Nëntë nga 27 tenderët janë monitoruar me fokus në fazën e pas tenderimit. Në njërin nga tenderët e përzgjedhur për monitorim të procesit të fazës së pas tenderimit ende nuk është nënshkruar kontrata edhe pse tenderi ishte hapur më 16.09.2022 dhe njoftimi për dhënie të kontratës ishte bërë më 14.04.2023. Nga tetë (8) kontratat e monitoruara, katër (4) kanë qenë kontrata për furnizim dhe katër (4) të tjera për punë.

Në kontratat për punë që janë monitoruar vërehen zvarritje e punimeve për shkak se projektet nuk janë bërë në përputhje me terrenin apo për shkak se nuk janë eliminuar të gjitha pengesat para se të fillojë puna. Shpronësimet, largimi i trafave, shtyllave elektrike apo telefonike janë disa prej pengesave në realizim të punëve në terren. Ndërsa për shkak të projekteve të dobëta dhe mungesës së diskutimeve për projektin shpesh komunat obligohen që të bëjnë ndryshime të projektit dhe pozicioneve.

Monitorimi i fazës së pas tenderimit për furnizim e shpërfaq edhe njëherë ndërlidhjen në mes të porosive të produkteve të panevojshme dhe çmimeve jo-normalisht të ulëta. Në listën e gjatë të produkteve që kontraktohen, zakonisht po futen edhe një pjesë e produkteve që janë shumë pak ose aspak të nevojshme për AK-në. Te produktet që janë pak të nevojshme, OE-të kanë vendosur çmime abnormalisht të ulëta, e më pas AK-të nuk i kanë porosituar ato asnjëherë. Kjo praktikë e minon mundësinë që të konstatohet me saktësi nëse është përzgjedhur oferta më e lirë, bazuar në nevojat reale të komunave.

3 [Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në Ministrinë e Shëndetësisë e SHSKUK, nënshkrimi i deklaratës nën betim nga hartuesit e specifikave teknike](#)

2. Para-tenderimi

2.1. Kriteret diskriminuese

Nëntë (9) nga 27 tenderët kanë pasur në fokus monitorimin në fazën e para-tenderimit, një prej fazave më të rëndësishme të prokurimit në Kosovë. Pesë (5) nga nëntë (9) tenderët kanë qenë për kontrata për punë ndërsa katër (4) të tjerë kanë qenë kontrata për shërbime.

Nga nëntë (9) tenderët që janë monitoruar në fazën e para-tenderimit, vetëm njëri prej tyre nuk ka pasur asnjë korrigjim të gabimeve në njoftime, përkatësisht kriteret teknike apo profesionale. Në tetë prej tenderëve të monitoruar, të paktën një herë ka pasur korrigjime të gabimeve përmes formularëve për korrigjim të gabimeve (B54). Në dy raste janë bërë nga gjashtë korrigjime të njoftimeve, kryesisht kishte ulje të kriterëve teknike apo profesionale.

Përkundër korrigjimeve dhe ankesave, AK kanë arritur që në shtatë raste t'i përfundojnë procedurat e prokurimit deri në nënshkrim të kontratave. Ndërsa, në dy prej tenderëve që janë monitoruar në fazën e para-tenderimit, kontratat nuk janë nënshkruar akoma, ku njëri është anuluar ndërsa tjetri ende është në proces.

Korrigjimi i gabimeve ka nxjerrë në pah kriteret diskriminuese apo të panevojshme që AK-të i kanë bërë nëpër tenderë.

Komuna e Gjakovës në tenderin për "Sanimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes në zona rurale - Kontratë dy vjeçare"⁴ kishte vendosur kriterë shumë të larta për projektin që ata synonin ta implementonin. Të njëjtat kanë mundur të jenë diskriminuese për ndonjë OE që ka pasur interes për të ofertuar në atë proces të prokurimit. Para ofertimit, Komuna e Gjakovës i kishte zbutur kriteret deri në përgjysmim të kërkesave për pajisjet e nevojshme që duhet t'i kenë operatorët ofertues.



9 / 27

Nëntë (9) nga 27 tenderët kanë pasur në fokus monitorimin në fazën e para-tenderimit, një prej fazave më të rëndësishme të prokurimit në Kosovë.

5 / 9

Pesë (5) nga nëntë (9) tenderët kanë qenë për kontrata për punë ndërsa katër (4) të tjerë kanë qenë kontrata për shërbime.

Në këtë aspekt, në njoftimin e parë të Komunës së Gjakovës është kërkuar që OE të ketë të paktën dy (2) lugë ngarkuese me peshë totale mbi 15 tonë, ndërsa kjo kërkesë është korrigjuar duke u kërkuar vetëm një (1) lugë ngarkuese. Në njoftimin e parë janë kërkuar tre (3) ekskavator me peshë totale mbi 15 tonë, por me korrigjimin e bërë është kërkuar vetëm një (1) i tillë. Fillimisht janë kërkuar dy (2) "mini ekskavator me peshë totale deri 5 tonë", ndërsa pas korrigjimit është kërkuar vetëm një (1).

⁴ Tenderi: [Sanimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes në zona rurale-Kontratë dy vjeçare](#); Nr të prokurimit: 632-22-14081-5-2-1

Pas korigjimit janë kërkuar vetëm dy (2) kamionë me konstrukcion ndërtim kiper me peshë të ngarkesës mbi 10 tonë, por më herët ishin kërkuar pesë (5) të tillë. Njëjtë është vepruar edhe me kërkesën fillestare që OE të ketë katër (4) “kamionë automikser me peshë të ngarkesës mbi 9m3”, ndërsa pas korigjimit numri i kërkuar ishte ndryshuar në vetëm dy (2) të tillë. Në njoftimin e parë ishin kërkuar nga dy (2) “autopompa për hedhjen e betonit me gjatësi mbi 32m” dhe “cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 9 tonë”, ndërsa me korigjim ishte kërkuar vetëm nga një (1).

Korigjimi i gabimeve është i mundur bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Megjithatë, zbutja e kriterëve për tenderin në fjal tregon se kriteret e para ishin vendosur më të larta se sa nevoja për ta realizuar atë projekt. Korigjimi i kriterëve vetëm disa ditë para hapjes së ofertave i lë shumë pak kohë OE-ve të rinj që t'i hyjnë garës për të njëjtin tender, krahasuar me Operatorët e tjerë që e kanë pasur afatin e plotë për ofertim.

Njëjtë ka ndodhur edhe në tenderin e Komunës së Pejës për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në sipërfaqe bujqësore të disa fshatrave⁵ me numër të prokurimit 635-23-1756-5-2-1. Pas publikimit të njoftimit për kontratë, Komuna e Pejës e ka bërë një ndryshim të kapaciteteve teknike dhe profesionale të kërkuara për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit. Një nga kërkesat në “Njoftimin për Kontratë” ka qenë që ofertuesit minimalisht duhet të kenë “Automikser betoni minimum tri copë”. Ky kriter është ulur dukshëm në korigjimin e bërë, pasi tash është kërkuar vetëm një “automikser betoni”.

Rekord të korigjimeve në njoftimet dhe dosjen e tenderit kishte në tenderin “Pastrimi i objekteve shkollore- Shkollat e mesme dhe institucione”⁶ me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1 të Komunës së Prishtinës.

Për këtë aktivitet një ditë pas publikimit të njoftimit për kontratë, AK-ja ka filluar ndryshimet përmes formularëve standardë për korigjimin e gabimeve në njoft-

imin e publikuar, dhe deri më datën 15.03.2023 janë publikuar jo më pak se gjashtë formularë për ndryshime/përmirësime dhe janë publikuar jo më pak se dy dosje të tenderit. Ndryshimet e bëra kanë ndodhur te kapaciteti teknik dhe profesional, te numri i punëtorëve nga lista e AK-së dhe te paga.

Komuna e Prishtinës fillimisht i kishte kërkuar gjashtë (6) automjete (pick-up) për bartjen e pajisjeve, por më vonë kërkesën e kishte ulur në vetëm dy automjete të nevojshme për realizimin e kësaj kontrate. Edhe kërkesën për “pesë makina (kositëse) me motor për kositjen e barit (timer)” e kishte ulur në vetëm dy copa. Po ashtu, në fillim i kishte kërkuar “katër makina për larjen e tepihave”, e më vonë e kishte ulur kërkesën në vetëm një të tillë. Madje, Komuna e Prishtinës në ndryshimin e fundit ka larguar nga lista e pajisjeve kërkesën për “makinë me motor për pastrimin e hapësirës së jashtme (makina duhet të jetë me fshesë)” si dhe ka bërë ndryshime në sasinë e pajisjeve të tjera. Të gjitha këto ndryshime janë bërë pa u publikuar informata të qarta në formularët për ndryshim, pasi që në asnjë prej gjashtë formularëve nuk janë cekur ndryshimet në Dosje të tenderit.

Si pasojë e ndryshimeve të shumta dhe paqartësive të krijuara në kërkesat e këtij tenderi, ka pasur edhe OE të cilët kanë qenë të interesuar për të ofertuar mirëpo nuk e kanë bërë. Në rastet kur kemi ndryshime të mëdha të njoftimeve, Ligji i Prokurimit⁷ i jep të drejtë Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit (ZPP) të anulojë në tërësi aktivitetin e prokurimit. Neni 21, pika 7, paragrafi d, i Rregullave të Prokurimit Publik thotë “nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtesë shpie në një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal të kontratës dhe ZPP e konstaton se ka një ndryshim rrënjësor ZPP duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit dhe të rishpallë të njëjtin nëse ende ka interes për të vazhduar me aktivitetin e njëjtë të prokurimit”⁸.

5 Tenderi “Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne siperfaqe bujqesore pjesa 1 LOT 1- Ndertimi i kanalit per ujitjen e siperfaqeve bujqesore ne fshatin Baran(- Jazi i Mullirit) LOT 2- Ndertimi i kanalit per ujitjen e siperfaqeve bujqesore ne fshatin Kotradiq dhe Kamenice LOT 3- Ndertimi i kanalit per ujitjen e siperfaqeve bujqesore ne fshatin Qallapek LOT 4- Ndertimi i kanalit per ujitjen e siperfaqeve bujqesore ne fshatin Vranoc LOT 5- Ndertimi i kanalit per ujitjen e siperfaqeve bujqesore ne fshatin Bugan”, Nr. prokurimi: 635-23-1756-5-2-1

6 Tenderi “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, Nr. prokurimi: 616-23-781-2-1-1

7 Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

8 Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurim publik

Ndryshime të shumta të specifikacionet teknike të kërkuara janë bërë edhe gjatë procesit të prokurimit “Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në Komunën e Gjilanit”⁹ me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1 të Komunës së Gjilanit. Ndryshimet më të mëdha përmes formularëve për korrigjim të gabimeve (B54) janë bërë pas vendimit të OShP-së me numër 631/22, i cili e aprovon si të bazuar kërkesën e OE “Er-Lis” Sh.P.K, dhe obligon Komunën e Gjilanit të bëjë ndryshime në dosjen e tenderit. Ndryshimet u kërkuar të bëhen kryesisht te aneksi për “pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm”, dhe nga kërkesat në dosjen e parë të tenderit.

2.2. Përmbajtje e ndryshme e “dosjes së tenderit” dhe “njoftimit për kontratë”

Dosja e tenderit është dokumenti kryesor i një procesi të prokurimit. Rregullorja e Prokurimit Publik thotë se “çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të të cilit OE-të do të krijojnë tenderët e tyre”. Tutje thuhet se Dosja e Tenderit duhet të hartohet në atë mënyrë që e njëjta të jetë e kuptueshme, të mos ketë fjali me dykuptimësi dhe mos të ketë nevojë për sqarime shtesë.

Në Rregulloren e Prokurimit Publik¹⁰, pika 17.12, precizohet që “kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike”. Por, gjatë monitorimit të 27 tenderëve, BIRN dhe Demokraci Plus kanë hasur në raste kur Dosja e Tenderit dhe Njoftimi për kontratë nuk janë identike. I tillë ishte rasti në tenderin e Komunës së Suharekës - “Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF Studençan, QMF Duhël, QMF Gjinoc” me numër të prokurimit 624-23-1039-5-2-1. Në dosjen e tenderit të datës 20.02.2023, te kërkesa për kapacitete ekonomike dhe financiare, komuna ka kërkuar që “OE duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i OE, gjatë tri viteve të fundit (2020-2021-2022)”. Ndërsa në njoftimin për kontratë ka kërkuar që dëshmia e qarkullimit vjetor të



Dosja e tenderit është dokumenti kryesor i një procesi të prokurimit. Rregullorja e Prokurimit Publik thotë se “çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të të cilit operatorët ekonomikë do të krijojnë tenderët e tyre”. Tutje thuhet se Dosja e Tenderit duhet të hartohet në atë mënyrë që e njëjta të jetë e kuptueshme, të mos ketë fjali me dykuptimësi dhe mos të ketë nevojë për sqarime shtesë.

⁹ Tenderi “Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit”, Nr. prokurimit: 651-22-10313-2-1-1

¹⁰ Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurim.

ofrohet për vitet 2019-2020-2022. Siç vërehet, AK-ja ka kërkuar dëshmi të qarkullimit vjetor për periudha kohore të ndryshme.

BIRN dhe Demokraci Plus kanë gjetur se në tenderin: “Sanimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes në zona rurale-Kontratë dy vjeçare”, me numër të prokurimit 632-22-14081-5-2-1 (Komuna e Gjakovës) kishte ndryshime në mes të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, por këto ndryshime ishin korigjuar duke i bërë të njëjtat pas ndryshimeve me dokumentin B54.

2.3. Mungesa e projektit ekzekutiv

Në kuadër të obligimeve të cilat derivojnë prej LPP-së¹¹, AK është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv, më saktësisht sipas nenit 28, pika 10 “Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. AK është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) specifikave teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit”.

Zyra Kombëtare e Auditimit, në raportin vjetor të auditimit për vitin 2022¹², ka thënë se “komunat kishin filluar procedura të prokurimit dhe kishin lidhur kontrata për punë, pa hartuar paraprakisht projektet ekzekutive të ndërtimit”. Madje, zhvillimi i procedurave të prokurimit në mungesë të projekteve ekzekutive ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njësisve kërkuese si dhe mos-funksionimit efikas të kontrolleve.

Një rast i ngjashëm ishte evidentuar në njërin prej tenderëve të monitoruar - “Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF Studençan, QMF Duhël, QMF Gjinoc” me numër të prokurimit 624-23-1039-5-2-1. Më 23 shkurt 2023, Komuna e Suharekës e ka iniciuar procedurën e prokurimit, pa pasur projekt ekzekutiv të projektuar për t’iu përshtatur relievit gjeografik në të cilin është planifikuar të ndërtohen QMF-të.

Komuna e Suharekës për qëllim të inicimit të procedurave të prokurimit e ka huazuar prej Komunës së Prizrenit projektin e projektuar për QMF Gjonaj dhe e ka përdorur si projekt model, të cilin e ka bashkëngjitur në Dosjen e Tenderit. BIRN Kosova dhe D+ përmes kërkesës për qasje ka kërkuar nga Komuna e Suharekës që të dërgojë ndonjë projekt ideor të projektuar saktësisht për këtë kontratë. Pas një hezitimi të gjatë, ekipi ka pranuar projektin kryesor për QMF Gjonaj, i cili është projektuar nga “Arsa Construction”. Ndërsa, nga ana e Komunës së Suharekës projekti është pranuar më 16.06.2023 për QMF Duhël dhe më 30.06.2023 për QMF Studeqan. Pra, projektet për këto QMF janë hartuar katër muaj pas hapjes së tenderit që ishte bërë më 23 shkurt 2023.

Edhe tenderi i komunës së Gjakovës: Sanimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes në zona rurale- Kontratë dy vjeçare, me numër të prokurimit 632-22-14081-5-2-1 ishte inicuar pa projekt ekzekutiv, por vetëm me parafundim.

2.4. Tenderët e paplanifikuar

Planifikimi i prokurimit është faza e parë e prokurimit publik. Brenda 15 ditëve nga shpallja e buxhetit për një vit fiskal, çdo AK duhet t’i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detaje të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që AK synon t’i prokurorë gjatë vitit fiskal. Planifikimi duhet të jetë në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e Prokurimit¹³.

Nga 27 tenderët e monitoruar, vetëm 19 tenderë kanë qenë pjesë e planeve të prokurimit të AK-ve respektive ndërsa në tetë (8) raste tenderët janë iniciuar edhe pse nuk ishin pjesë e planit të prokurimit. Komunitat kanë dhënë arsye të ndryshme për inicimin e aktiviteteve të prokurimit edhe pse nuk i kishin paraparë në fillim të vitit. Në disa raste, është gjetur se zotimi i mjeteve nga AK ishte dukshëm më i ulët se sa kostoja e tenderit.

11 [Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092](#)

12 Zyra Kombëtare e Auditimit, “[Raporti vjetor 2022](#)”

13 [Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës](#), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 8, paragrafi 2, dhe Neni 5, paragrafi 5.4 I Rregullores për Prokurim Publik.

Për shembull, Komuna e Gjilanit në muajin gusht të vitit 2022 e kishte iniciuar tenderin me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1, për të angazhuar një kompani për “rregullimin e dyshemesë të sallës në shkollën “Zenel Hajdini”¹⁴. AK ka iniciuar procedurat e prokurimit për këtë aktivitet pa planifikuar mjete të mjaftueshme financiare në planin e prokurimit për vitin 2023, por as në KAB 2022-2025¹⁵.

Njëjtë kishte ndodhur edhe në tenderin tjetër - “Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në Komunën e Gjilanit”¹⁶, me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1. Ky aktivitet ka qenë i planifikuar në planin e prokurimit për vitin 2022, për të cilin ishin planifikuar 10,000 euro, ndërsa në njoftimin për kontratë vlera e parashikuar është 340,000 euro, për të cilin ka edhe zotim nga Drejtoria e Financave. Pra, Komuna e Gjilanit ka iniciuar këtë aktivitet pa pasur mbulueshmëri financiare. Punimet në projekt janë të planifikuara të zgjasin për 36 muaj ndërsa, në Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 për këtë aktivitet janë të ndara vetëm 65,000 euro, konkretisht për vitin 2022 janë planifikuar 25,000 euro, dhe për vitet 2023 dhe 2024 janë të ndara nga 20,000 euro.

Edhe tenderi “Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu - Suharekë - ritender”¹⁷ me numër të prokurimit 624-22-8920-5-1-1, ishte iniciuar përkundër që nuk kishte mjete të mjaftueshme financiare të zotuar nëpër dokumentet buxhetore. Komuna e Suharekës në dosjen e këtij tenderi kishte caktuar si vlerë të parashikuar 870,000 euro ndërsa në planin e prokurimit për vitin 2022 ishin planifikuar 182,500 euro.

2.5. Shkurtimi i afateve për pranimin e tenderëve

Secili AK, në publikimin e aktivitetit të prokurimit publik është i obliguar të lë një periudhë kohore për pranimin e ofertave nga OE-të. Ligji ka paraparë afate më të gjata për dorëzim të ofertave për tenderët që janë në vlera



BIRN dhe D+, gjatë monitorimit të 27 aktiviteteve të prokurimit, kanë gjetur raste kur janë shkurtuar afatet e ofertimit pa një arsyetim bindës, por ka pasur edhe raste kur nuk janë respektuar afatet e përcaktuara për vlerësimin e të njëjtave.

¹⁴ Tenderi “Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini - Ri -Ri-Tender”, Nr.prokurimit:651-22-7819-5-2-1

¹⁵ Komuna Gjilan “Korniza afatmesem buxhetore 2023-2025”

¹⁶ Tenderi “Sinjalizimi Horizontal,Vertikal dhe paisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit”, Nr.prokurimit:651-22-10313-2-1-1

¹⁷ Tenderi “Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu - Suharekë-ritrnder”, Nr.prokurimit:624-22-8920-5-1-1

të mëdha. Afatet kohore minimale që secili AK duhet t'i zbatojë janë të parapara te Neni 8, paragrafi 2, Neni 5, nenet 44, 45 dhe 46 të Ligjit të Prokurimit Publik¹⁸. Afatet dallojnë në bazë të vlerave të parashikuara të kontratës. Ndërsa rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore parashihen atëherë “nëse kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente; (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve kohore të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji ose nëse është e aplikueshme edhe në nenin 45 të këtij ligji”.

BIRN dhe D+, gjatë monitorimit të 27 aktiviteteve të prokurimit, kanë gjetur raste kur janë shkurtuar afatet e ofertimit pa një arsytim bindës, por, ka hasur në raste kur nuk janë respektuar afatet e përcaktuara për vlerësimin e të njëjtave.

Komuna e Rahovecit e ka shkurtuar afatin për pranimin e tenderëve, sic ia mundëson Rregullorja për Prokurim Publik, në tenderin - “Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në Komunën e Rahovecit”¹⁹, me numër të prokurimit 623-23-179-5-1-1. Ky tender kishte një vlerë të parashikuar prej 697 mijë euro, pra ishte tender i madh. Komuna e kishte shkurtuar afatin e dorëzimit të ofertave.

Tenderi ishte hapur më 27.03.2023, ndërsa data e fundit për pranim të ofertave ishte caktuar 20.04.2023, pra afati për dorëzimin e ofertave ishte caktuar 24 ditë në vend të 40 ditëve sa e kërkonte ligji. Në rastet kur publikohet “njoftimi paraprak”, AK-ve ju mundësohet që të shkurtojnë afatin në 24 ditë nga 40 sa kërkon ligji.

Arsytimi i komunës ishte se ishte “kërkesë nga njësia kërkuese që ky projekt të shpallet në procedurë të përsheptuar dhe të bëhet shkurtimi i afatit për hapjen e ofertave, për shkak të kushteve atmosferike në muajt në vijim dhe vendi në të cilin do të realizohet projekti në vazhdimësi atakohet nga vërshimet në sezonin vjeshtë - dimër, dhe sipas Nenit 6.5, pika b, të RrUOPP-së²⁰, ku njoftimi paraprak i mundëson shkurtimin e afatit kohor

por jo më pak se 24 ditë”.

Edhe pse Komuna e Rahovecit e kishte shkurtuar afatin për dorëzimin e tenderëve me arsyetimin se mund të ketë vërshime, asaj i janë dashur 50 ditë për vlerësim të ofertave. Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte publikuar më 09.06.2023, apo 50 ditë pas hapjes së ofertave që ishte afati maksimal që lejohet me ligj për t'i vlerësuar ofertat.

Në paragrafin 1 të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës²¹, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 thuhet se AK duhet të themelojë një komision vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.

Ndërsa në nenin 40.3 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik²² përmendet se procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.

Shkurtim të afateve kishte pasur edhe në tenderin e Komunës së Gjilanit me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1, për të angazhuar një kompani për “rregullimin e dyshemesë të sallës në shkollën “Zenel Hajdini””. Shkurtimi i afateve për pranimin e ofertave ishte bërë me arsyetimin se “në shtator fillon procesi mesimor dhe duhet të përfundojë në atë kohë”.

Përkundër faktit që komuna i kishte shkurtuar afatet e ofertimit, e njëjta ka bërë disa herë shkelje të Ligjit të Prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave dhe për pasojë tenderi ende nuk është përfunduar. Pra, ka filluar viti tjetër shkollor dhe dyshemeja e kësaj shkolle ende nuk është renovuar.

Komuna e Gjilanit i kishte shkurtuar afatet për pranim

18 [Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092](#)

19 Tenderi “Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (gropa skeptike) në Komunën e Rahovecit” Nr.prokurimit:623-23-179-5-1-1

20 [Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurim](#)

21 [Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092](#)

22 [Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurim](#)

të ofertave edhe në tenderin - "Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në Komunën e Gjilanit"²³, me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1. Shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave ishte bërë me arsyetimin se për një kontratë paraprake është përbushur vlera e parashikuar dhe si rrjedhojë nuk po mundën me ofru shërbime ndaj qytetarëve. Shkurtrim të afateve kishte edhe në tenderin "Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu"²⁴, të iniciuar nga Komuna e Suharekës.

Komuna e Suharekës kishte bërë shkurtrimin e afateve për pranimin e ofertave të aktivitetit të prokurimit me numër 624-22-8920-5-1-1, me arsyetimin se "ky projekt është planifikuar vetëm faza e parë në vlerë të mesme për shkak të buxhetit, asambleja ka aprovuar bartjen e buxhetit për ta kompletuar projektin dhe tash ka kaluar në vlerë të madhe, megjithatë si vlerë e mesme është në planifikim të prokurimit dhe duke marrë parasysh nevojën urgjente që punët të kryhen para sezonit të dimrit. ZKA ka aprovuar kërkesën për shkurtrim afati".

Por, pas publikimit të njoftimit për kontratë kishte pasur një korrigjim të gabimeve në njoftimet, e më vonë edhe dy ankesa²⁵ në OSHP. Kjo e fundit kishte konstatuar shkelje ligjore në njërin nga vendimet e saj, kurse më vonë Komuna e Suharekës kishte vendosur që të anulohet në tërësi këtë tender me arsyetimin se nuk kishte oferta të përgjegjshme.

Shkurtrim të afateve për pranim të ofertave kishte edhe në tenderin e Komunës së Pejë për "Furnizim me material higjienik dhe ushqimor për nevojat e SHCK-së që nuk janë pjesë të AQP-së"²⁶, me numër të prokurimit 635-22-11129-1-1-1. Edhe pse në këtë tender ishin kërkuar produkte ushqimore, higjienike dhe poça elektrike, komuna e kishte shkurtuar afatin për ofertim. Ky projekt nuk ka qenë në planin e prokurimit, ndërsa vlera e parashikuar për kontratë në këtë tender është 192,010 euro. Sipas komunës, arsyeja për iniciimin e procedurës së përshpejtuar është pasi njësisia kërkuuese ka mbetur pa material ushqimor dhe higjienik për çerdhe dhe shkolla dhe duhet që kjo procedurë të përshpejtohet.

2.6. Komisionet sekrete për hartimin e specifikacioneve teknike

Një prej pjesëve kryesore në një proces të prokurimit është hartimi i kushteve teknike, profesionale dhe financiare për një tender të caktuar. Përcaktimi i specifikacioneve teknike të një tenderi, zakonisht bëhet nga njësisia kërkuuese. Varësisht nga mënyra e përcaktimit të kushteve dhe kriterëve mund të vendoset se cilat kompani mund të fitojë apo sa oferta do të pranohen.

Neni 39, pika 12 e Rregullores për Prokurim Publik²⁷ thotë se personat që kanë marrë pjesë në hartim të specifikacioneve ose termave të referencës nuk duhet të jenë të përfshirë në Komisionin për vlerësim të ofertave. "Anëtarët e Komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të jenë anëtarë që nuk janë të përfshirë në përgatitjen e specifikimeve ose termave të referencës".

Për të parë nëse ka raste kur personat që i kanë hartuar specifikacionet teknike vazhdojnë të jenë pjesë e procesit të prokurimit, BIRN dhe D+ kanë kërkuar informacione për emrat e personave që i kanë hartuar specifikacionet teknike në 27 tenderët që kanë qenë në fokus. Nga 27 tenderët e monitoruar, vetëm në 11 raste AK-në i kanë qenë në gjendje të na tregojnë emrat dhe pozitat e personave apo emrin e kompanisë që i kanë hartuar specifikacionet teknike të një tenderi.

Ndërsa, për 16 tenderët e tjerë, AK-të nuk janë përgjigjur fare, apo kanë thënë se njësisia e kërkuuese i ka hartuar specifikacionet, pa treguar se cilët persona kanë marrë pjesë në komisionin për hartim të specifikacioneve teknike.

AK-të nuk kanë një procedurë të standardizuar në hartimin e specifikacioneve teknike. Bazur në monitorimin e 27 tenderëve, në pjesën më të madhe të tyre nuk është hasur në një vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA) të një institucioni për caktimin e personit apo personave/komisionit për hartim të specifikacioneve. Në mungesë të një vendimi të tillë, BIRN dhe D+ e kanë të pamundur të arrijnë në përfundim nëse

23 Tenderi "Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore ne komunën e Gjilanit" Nr.prokurimit: 651-22-10313-2-1-1

24 Tenderi "Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu - Suharekë-ritrnder" Nr.prokurimit: 624-22-8920-5-1-1

25 Organi Shqyrtues i Prokurimit [OSHP]

26 Tenderi "Furnizim me material Higjienik dhe Ushqimor per nevojat e SHCK-se qe nuk jan pjes te AQP-se" Nr.prokurimit: 635-22-11129-1-1-1"

27 Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurim



Nga **27** tenderët e monitoruar, në

15 prej tyre kishte korrigjime të njoftimeve,

kryesisht te specifikat teknike dhe ato profesionale të kërkuara nga AK-të si kushte minimale që duhet të plotësohen për të marrë pjesë në tenderë. Pjesa më e madhe e korrigjimeve janë bërë për të ulur kriteret teknike dhe profesionale të kërkuara fillimisht. Ulja e kriterëve nënkupton se ato fillimisht nuk kanë qenë në proporcion me madhësinë e projektit që është planifikuar të kryehet apo kanë qenë diskriminuese për operatorë të caktuar.

personat që i kanë hartuar specifikacionet teknike, më vonë kanë marrë pjesë në komisionet vlerësuese për të njëjtin tender, apo kanë qenë të kyçur në menaxhim të kontratës apo kanë qenë pjesë të Komisionit për pranimin e punëve.

Nga 27 tenderët e monitoruar, në 15 tenderë kishte korrigjime të njoftimeve, kryesisht te specifikat teknike dhe ato profesionale të kërkuara nga AK-të si kushte minimale që duhet të plotësohen për të marrë pjesë në tenderë. Pjesa më e madhe e korrigjimeve janë bërë për të ulur kriteret teknike dhe profesionale të kërkuara fillimisht. Ulja e kriterëve nënkupton se ato fillimisht nuk kanë qenë në proporcion me madhësinë e projektit që është planifikuar të kryehet apo kanë qenë diskriminuese për operatorë të caktuar.

Disa prej komunave janë mjaftuar me informacionin se specifikacionet për tenderë janë hartuar nga njësi kërkuese. Komuna e Suharekës për tenderin “Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF Studençan, QMF Duhël, QMF Gjinoc”²⁸ kishte thënë se “hartimi i specifikave është bërë nga zyrtarë të kësaj komune”.

Disa prej komunave kanë treguar emrat e personave që i kanë hartuar specifikacionet teknike. Ato kanë nxjerrë në pah rëndësinë e vogël që i japin këto institucione njërit prej hapave më të rëndësishëm në prokurim: hartimin e specifikacioneve teknike.

Për shembull, Komuna e Gjilanit ka thënë se drejtori i shkollës “Zenel Hajdini”, profesor i matematikës, i ka hartuar specifikacionet teknike për tenderin “Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini - Ri -Ritender”²⁹. Ky tender ishte hapur në verën e vitit 2022 me synimin që para vitit shkollor 2022/2023, shkolla “Zenel Hajdini” të ketë dyshemenë e renovuar, mirëpo ende nuk është nënshkruar kontrata edhe pse ka filluar viti shkollor 2023-2024.

Komuna e Gjilanit tri herë i kishte miratuar kërkesat për rishqyrtim të OE-ve duke i rivlerësuar ofertat. Bazuar në ankesat e OE-ve, Gjykata e Tenderëve ka marrë dy vendime për këtë tender, duke i anuluar dy herë vendimet e Komunës së Gjilanit dhe duke e kthyer tenderin

28 Tenderi “Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF Studençan, QMF-Duhël dhe QMF -Gjinoc”. Nr.Prokurimit: 651-22-10313-2-1-1

29 Tenderi “Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini - Ri -Ritender”, Nr.prokurimit: 624-23-1039-5-2-1

në rivlerësim. Në vendimin e parë, OShP kishte konstatuar se një prej kriterëve të kërkuara nga Komuna e Gjilanit nuk ishte specifik dhe i matshëm, prandaj kishte vlerësuar se njëri nga OE ishte eliminuar në mënyrë të kundërligjshme.

“Bazuar në kërkesat e dosjes është vështirë të vlerësohet kualifikimi i punëtorit të dyshemesë pasi nuk është theksuar tek kërkesat kualifikuese se cka nënkupton me certifikim, çfarë lloj certifikimi duhet të ketë punëtori për dysheme, pasi që dyshemetë shtrohen me materiale të ndryshme. OE-të ankuese dhe as OE i rekomanduar nuk mund të eliminohen me arsyetimin se nuk kanë referenca pasi që fjala a është për punë ndërtimore dhe secili objekt ka dysheme dhe varet se me çfarë lloj materiali ndërtohet.”- thuhet në vendimin e OSHP-së (PSH. Nr. 592/22. Tenderi I Komunës së Gjilanit ende nuk është finalizuar, pasi një ankesë e re është dorëzuar në OSHP, më 30.08.2023.

Komuna e Gjilanit, në një rast tjetër ia kishte besuar një profesionisti të fushës hartimin e specifikacioneve teknike për tenderin “Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në Komunën e Gjilanit”³⁰, me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1. Hartimi i specifikave është bërë nga zyrtari i Drejtorisë për shërbime publike, infrastrukturë dhe banim, i cili me profesion është inxhinier i komunikacionit.

Përkundër që specifikat teknike janë hartuar nga një profesionist, OShP kishte vlerësuar se janë vendosur kriterë diskriminues dhe e kishte obliguar Komunën e Gjilanit që të bëjë përmirësime në Dosjen e Tenderit. OSHP-ja në vendimin e saj (PSH. 631/22) kishte kërkuar që të hiqet obligimi që OE të ketë marrëveshje me prodhuesin apo distributorin e autorizuar të “pistonave hidraulik”, duke konstatuar se OE mund të shërbejë edhe me nënkontraktues për këto pajisje. Njëjtë është kërkuar që të largohet obligimi që OE të ketë printer apo katërpërpunimin e foljes. Edhe ky tender ende nuk është përfunduar për shkak të ankesave në OSHP.

Komuna e Prishtinës ka thënë se specifikat teknike për tenderin “pastrimi i objekteve shkollorë- Shkollat e mesme dhe institucione”³¹, me numër të prokurimit 616-23-781-2-1-1, janë hartuar nga zyrtarët e Drejtorisë për Arsim, Arbër Gashi dhe drejtoresha e Arsimit, Besiana Musmurati.

2.7. Një operator një lot, mundësi për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM) por kosto për komuna

Në dy tenderë të analizuar, komuna e Pejës ka ndjekur mënyrën e kontraktimit përmes kriterit që një kompani nuk mund të fitonte me shumë së një llot. Si praktikë e nisur nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), dhe e përkrahur edhe nga akterë të tjerë, përfshirë edhe shoqëritë civile, kjo mënyrë e kontraktimit ishte menduar që të rriste mundësitë për përfshirje edhe të NVM-ve në tregun kombëtar të prokurimit publik. Disa vite pas fillimit të kësaj praktike, faktet tregojnë që përdërisa mundësitë për NVM po rriten, njëjtë po rritet edhe kostoja e AK-ve gjatë përdorimit të këtij modeli.

Tenderin për “Ndërtimin e kanaleve të ujitjes”³², Komuna e Pejës e kishte ndarë në pesë lloje. Në njoftimin për kontratë është thënë se një OE maksimumi mund të fitojë një llot, pra vetëm një kontratë. BIRN dhe D+ e kanë analizuar procesin e prokurimit duke përfshirë vendimin për dhënien e kontratës për të parë nëse është rritur potencialisht kostoja buxhetore për shkak të kushtëzimit se një OE mund të fitojë vetëm një llot.

Pas analizës rezultoi se lloti i parë i është dhënë operatorit që nuk e kishte ofertën më të lirë të përgjegjshme. Kontrata i ishte dhënë OE “V-Shala SHPK” me çmim prej 69,760 euro, që ishte për 1,600 euro më e lartë se oferta më e lirë e GOE “VB.Tofaj; Etnogroup CO shpk; Niva Construction shpk”. Por, kjo e fundit e kishte fituar llotin 3, prandaj nuk mund të fitonte më shumë se një llot.

E njëjta situatë është përsëritur edhe në llotin e dytë,

30 Tenderi “Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në Komunën e Gjilanit”, Nr.prokurimit:651-22-10313-2-1-1

31 Tenderi “Pastrimi i objekteve shkollorë- Shkollat e mesme dhe institucione” Nr.prokurimit: 616-23-781-2-1-1

32 Tenderi “Ndërtimin e kanaleve të ujitjes” Nr.prokurimit: 635-23-1756-5-2-1

të cilin e kishte fituar GEO "KBC Group SH.P.K & ARFA GROUP SH.P.K" me çmim total të ofertës 71,750.51 euro. Në këtë llot, oferta më e lirë ishte dorëzuar nga OE "N.P Auremont" me çmim 62,719 euro. Edhe pse e kishte ofertën më të lirë për 9,031 euro, asaj nuk i është dhënë lloti i dytë pasi e kishte fituar llotin e tretë dhe sipas njoftimit për kontratë e njëjta nuk mund të fitonte më shumë se një llot.

Edhe në llotin e tretë kontrata nuk i ishte dhënë ofertës më të lirë. Kontratën e kishte fituar kompania "N.P. Auremont" me çmim të ofertës 76,484.40 euro edhe pse "VB. TOFAJ; ETNOGROUP CO SH.P.K.; NIVA Construction' SH.P.K" në këtë tender kishte ofertuar me vetëm 52,858 euro. Por kjo e fundit ishte rekomanduar për kontratë në llotin e katërt.

Edhe në llotin e pestë kontrata i është dhënë OE "ENGINEERING GROUP SH.P.K" me çmim prej 60,505 euro, ndërsa dy operatorë të tjerë ekonomikë kishin çmim më të lirë, "V - SHALA" SH.P.K 59,722.80 euro (fituese e llotit 1) dhe N.P. "Auremont" (fituese e llotit 2) me çmim 58,877.10 euro. Të dy OE-të që kishin çmimin më të lirë në llotin e pestë ishin fitues në dy lloje të tjera.

Edhe tenderi tjetër i Komunës së Pejës për "Ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve në Rugovë"³³ ishte ndarë në 7 lloje. Në llotin e parë për kontratë ishte rekomanduar kompania "Graniti Shpk" që kishte ofertuar 918,214 euro. Oferta më e lirë në këtë llot ishte e kompanisë "RSM Company SH.P.K" në vlerë prej 887,585.26 euro. OE "RSM Company SH.P.K, i është dhënë kontrata në llotin 7, me çmimin më të lirë të ofertës 306,262.07 euro pas ankesave në OSHP nga "Graniti Shpk".

33 Tenderi "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Rugovë LOT 1 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Varri i Sykut - Bellopaq" faza I LOT 2 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin "Shtype i Madh- Qafa e Broqit LOT 3 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin "Rekë e Allagës- Pecaj" LOT 4 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Koshutan - Gunishtë LOT 5 Asfaltimi i rrugës "Koshutan Pepajë" LOT 6 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Kuqisht (Lagja e Bardhaj) LOT 7 Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dugaivë vazhdim pjesa II", Nr.prokurimit: 635-22-11435-5-1-1

3. Tenderimi

3.1. Vonesat në vlerësimin e ofertave

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është prej fazave kryesore të prokurimit. Në këtë fazë, bazuar në vendimet e OSHP-së, bëhen më së shumti shkelje të Ligjit të Prokurimit. Bazuar në nenin 59 të Ligjit të Prokurimit Publik³⁴, AK, rast për rast, e themelon një Komision vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Në Rregulloren e Prokurimit Publik³⁵ të hartuar nga KRPP-ja thuhet se “ZPP do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të vlerësimit të tenderëve për ZKA, i cili do të aprovojë të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedhë anëtarë alternativë për Komisionin”. Madje, anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve mund të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të vlerësimit.

Për dallim nga personat që e kanë bërë hartimin e specifikacioneve teknike, emrat e komisioneve vlerësuese janë në secilin raport të vlerësimit të tenderëve. BIRN dhe D+ i kanë analizuar emrat që kanë qenë pjesë e komisioneve vlerësuese dhe ka rezultuar se në secilin prej komisioneve vlerësuese kishte të paktën një njohës të fushës në të cilin lidhej kontrata.

Procesi i vlerësimit të ofertave fillon që nga momenti kur bëhet hapja e ofertave dhe përfundon në momentin kur AK-ja nxjerr Njoftimin mbi vendimin e AK-së. Në paragrafin 1 të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)³⁶ thuhet se AK duhet të themelojë një komision vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.

Ndërsa në nenin 40.3 të Rregullores për Prokurim Publik³⁷ përmendet se procedura për ekzaminimin,

vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK-të, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.

Gjatë monitorimit të tenderëve është hasur në disa raste kur AK-të e kanë zvarritur procesin e vlerësimit të ofertave. Për shembull, Komuna e Prishtinës më 09.06.2022 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me qëllim të “ndërtimit të kolektorit në Hajvali”³⁸. Për të njëjtin tenderi, më 27.07.2022 e kishte publikuar procesverbalin e hapjes së ofertave, ndërsa më 29.09.2022 ka nxjerrë Njoftimin mbi vendimin e AK-së. Saktësisht, i janë nevojitur 63 ditë që komuna ta bëjë vlerësimin e ofertave të OE-ve nga maksimumi 50 sa janë të lejuara. Rrjedhimisht, Komuna e Prishtinës e ka tejkaluar për 33 ditë afatin e vlerësimit të ofertave, ndërsa afatin maksimal e kishte kaluar për 13 ditë.

Edhe Komuna e Rahovecit kishte vonesa në vlerësimin e ofertave për tenderin “Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në Komunën e Rahovecit”³⁹, me numër të prokurimit [623-23-179-5-1-1](#).

Tenderi ishte hapur më 27.03.2023, ndërsa data e fundit për pranimit të ofertave ishte caktuar 20.04.2023. Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte publikuar më 09.06.2023, apo 50 ditë pas hapjes së ofertave që ishte afati maksimal që lejohet me ligj për t’i vlerësuar ofertat.

34 [Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092](#)

35 [Rregulloren e Prokurimit Publik](#)

36 [Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092](#)

37 [Rregulloren e Prokurimit Publik](#)

38 Tenderi “Ndërtimi i kolektorit në Hajvali”, Nr.prokurimit: 616-22-5630-5-1-1

39 Tenderi “Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (gropa skeptike) në Komunën e Rahovecit” Nr.prokurimit: 623-23-179-5-1-1

3.2. Referencat e dyshimta

Komuna e Prishtinës më 09.06.2022 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me qëllim të “ndërtimit të kolektorit në Hajvali”. Ky tender me numër të prokurimit 616-22-5630-5-1-1, kishte vlerë të parashikuar prej 800,000 euro. Pesë OE kanë dorëzuar ofertë në tenderin në të cilin u aplikua procedura e hapur. Ndërsa kriteri i dhënies së kontratës u caktua kriteri me çmimin më të ulët të përgjegjshëm. Ky tender u shqyrtua tri herë nga OShP-ja, të cilët kishin konstatuar se kishte shkelje ligjore. Madje, OSHP-ja ishte detyruar të lëshojë urdhëresë dhe kishte filluar procedurën për tërheqjen e licencës së zyrtarit të prokurimit.

Fillimisht, komisioni i parë i vlerësimit ka rekomanduar për nënshkrim të kontratës konzorciumin “N.N.Sh. Co-Ing & N.N.T Bini Sh.P.K & Hidro Project Sh.P.K”. Të pakënaqura me këtë vlerësim, kërkesë për rishqyrtim kanë bërë dy OE, të cilat janë vlerësuar si të pabazuara nga AK-ja. OShP përmes vendimit (PSh. Nr. 516/22) urdhëroi komunën që të bëjë rivlerësim të tenderit. Për shkak të mosveprimeve të AK-së në adresë të saj erdhi edhe një urdhëresë e lëshuar nga OShP, përmes së cilës urdhëroi atë që ta zbatojë vendimin me NR. 516/22.

Komuna e Prishtinës më 27.01.2023, duke u bazur në raportin e rivlerësimit e publikoi “Njoftimin për vendim të AK-së” dhe rekomandoi për nënshkrim të kontratës konzorciumin e njëjtë që kishte rekomanduar edhe në vlerësimin e parë, e cila si lider kishte kompaninë “N.N.Sh. Co-Ing”.

Gjatë procesit të rivlerësimit, AK-ja ka dërguar pyetje sqaruese te kompania “Co-Ing”, në të cilën ka kërkuar sqarime sa i përket referencave të udhëheqësit të punimeve, Zenun Tolaj. Konkretisht, AK-ja kërkoi që të dorëzohen dëshmi që Tolaj ka menaxhuar të paktën një projekt me vlerë të parashikuar 800,000 euro. OE i dërgoi Komunës së Prishtinës disa referenca të lëshuara nga kompania “PMN Sh.P.K” (kompani e specializuar për mbikëqyrje, ndërtim dhe projektim), sipas të cilës Zenun Tolaj ka qenë menaxher në projekte të ndryshme kapitale e të cilat e arrijnë vlerën e caktuar nga AK-ja.

Në sqarimet e dërguara, kompania ka dërguar referenca të prodhuara nga “PMN”, sipas të cilës menaxheri i propozuar, Zenun Tolaj, ka udhëhequr vendpunishten për kontratat si në vijim:

- “LOT 3 - Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Faza e dytë”

- “Asfaltimi i rrugës Fortesë - Hamoc - Rahovec”

Në Agjencinë për Regjistrim të Bizneseve pronar i kompanisë “P.M.N Shpk” figuron Zenun Tolaj. BIRN dhe D+ për të vërtetuar këto referenca ka komunikuar me Komunën e Rahovecit, e cila ka thënë se Tolaj nuk ka qenë menaxher i kontratës, i propozuar nga kompanitë të cilat i kanë nënshkruar ato kontrata. Sipas Komunës së Rahovecit, menaxherët e propozuar nga kompanitë fituese për kontratat respektive:

- Për kontratën “LOT 3 - Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Faza e dytë” e nënshkruar nga kompania “KAG Asphalt”, menaxher i punishtes nga fillimi deri në fund të punimeve ka qenë Sadik Sadiku;

- Për kontratën “Asfaltimi i rrugës Fortesë - Hamoc - Rahovec” e nënshkruar nga “Euroasphalt”, menaxher i punishtes nga fillimi deri në fund të punimeve ka qenë Fatmir Kryeziu;

Për të vërtetuar tutje, BIRN dhe D+ kanë kërkuar sqarime shtesë nga Komuna e Rahovecit, për të parë nëse i njëjti ka qenë menaxher i caktuar nga AK-ja për këto kontrata.

Në përgjigjet e pranuar nga Komuna e Rahovecit, del që Zenun Tolaj ka qenë menaxher i kontratave të lartcekura, i caktuar nga AK-ja.

BIRN dhe Demokraci Plus kanë kërkuar sqarime nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRrPP) për të parë nëse menaxheri i kontratës i caktuar nga OE dhe ai nga AK kanë përgjegjësi të njëjta.

KRPP-ja, në përgjigjet e tyre, kanë thënë se për përgjegjësit e menaxherit të kontratës të caktuar nga OE nuk ka asnjë përshkrim të punëve në legjislacionin e prokurimit.

Bazuar në Rregulloren e Prokurimit (neni 70.23), Menaxheri i Kontratës i caktuar AK-ja menaxhon obligimet dhe detyrat e AK të specifikuar në Kontratë, si dhe të sigurohen që OE i kryen punët bazuar në kushtet e specifikuar në Kontratë.

Ndërsa, në nenin 70.24 të kësaj rregullore janë dhënë funksionet e menaxherit të kontratës të caktuar nga AK, e asnjë prej tyre nuk thotë se i njëjti është udhëheqës i punishtës apo që është përgjegjës për të udhëhequr punën që realizohet në terren. Përgjegjësin e menaxherit të kontratës të caktuar nga AK, kryesisht lidhen me mbikëqyrje, kontroll të cilësisë së punimeve, pranimin e punëve shtesë etj.

Edhe pas vendimit të dytë të Komunës së Prishtinës, serish kishte ankesa në OSHP nga OE "Valdrini". OSHP, përmes vendimit (2023/0082) e ka shpallur si të jashtafatshme ankesën e kësaj kompanie. Por në përmbytje kjo lëndë u trajtua duke e obliguar komunën që ta zbatojë vendimin e kalur të OSHP-së. Pjesë e këtij vendimi po ashtu ishte edhe masa ndëshkuese në të cilën shqiptohet gjobë me të holla prej 5000 euro, pasi që AK-ja nuk i ka respektuar vendimet dhe urdhëresat paraprake për këtë aktivitet. Për më shumë, si pjesë e masës ndëshkimore, paneli shqyrtues inicioi procedurë për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër ZPP.

KRRPP si institucion në domenin e të cilit hyjnë përgjegjësitë për revokim të licencave të zyrtarve të prokurimit, përmes vendimit 24/2023 i shqipton vërejtje me shkrim për mosrespektim të LPP-së, Nexhmi Mekolli.

Vlerësimi i fundit i këtij aktiviteti bëhet më 12.05.2023 dhe përmes të cilit u rekomandua për nënshkrim të kontratës GOE "Valdrini" Sh.P.K & Limitproject Sh.P.K. & N.N.P. Ndërtimi".

Kësaj kompanie fillimisht i ishte thënë se i mungonin kontratat e dy teknikëve të ndërtimtarisë. Po ashtu, është një dokument "Kronologjia e procesit për ndërtimin e kolektorit Hajvalia", të cilën Komuna e Prishtinës e kishte dërguar në OSHP si argument e saj, në të cilin thuhet se ky ofertues nuk i ka kontratat e teknikëve të ndërtimtarisë. BIRN dhe D+ kanë kërkuar sqarime nga Komuna e Prishtinës për plotësimin e këtij kriteri, por ata kanë thënë se OSHP-ja e ka shpallur të përgjegjshme këtë kompani.

"GOE: i dërgon në mënyrë elektronike dokumentacionin në E-Prokurim pasi që në Vendimin e AK-së është cekur që të njëjti i mungojnë kontratat, por meqenëse ka dorëzuar listën dhe i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e tjera siç është diploma e noterizuar, referenca etj, dhe të njëjtin vendimi i OSHP-së e shpall të përgjegjshëm, i njëjti pa ndonjë Kërkesë për sqarim nga AK-ja por vetëm pas marrjes së vendimit të OSHP-së të datës 22.02.2023 i ka ngarkuar në sistem dy dokumentet e lartcekura më datë 03.03.2023 dhe 06.04.2023, ende pa e pritur rivlerësimin e ofertave".⁴⁰

BIRN dhe Demokraci Plus serish kanë kërkuar sqarime nga Komuna e Prishtinës, të cilët i kanë dërguar dy dokumente që ky OE i ka ngarkuar në E-prokurim si dëshmi. Dokumenti që është dërguar si dëshmi është "Kontrata në vepër", e nënshkruar në mes të kompanisë «Limit Project» dhe Driton Çelaj, teknik i ndërtimtarisë. Kontrata e ka datën 01.06.2022. Në këtë kontratë, të datës 01.06.2022, është cekur edhe numri i prokurimit të tenderit që kanë ofertuar. E tenderi i cekur në këtë kontratë ishte publikuar më 10.06.2022, apo 10 ditë para se të nënshkruhet kontrata. Numri i prokurimit nuk ka qenë publik me datën 01.06.2022.

⁴⁰ Përgjigja e Flamur Sallahu, Zyrtar i Lartë i Prokurimit dhënë më datë 14.09.2023.

4. Faza pas tenderuese

Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, ZKA (kryetari i komunës), bazuar në Ligjin e Prokurimit e cakton një menaxher të kontratës. Në rastet kur kontrata është e vlerës së madhe e cakton edhe një mbikëqyrës të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës. Në Ligjin e Prokurimit thuhet se pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, ZPP do ta informojë ZKA, i cili me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Kontratës, përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikëqyrës të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës, të cilët do të kenë përgjegjësitë si në paragrafet nga 70.23 deri në 70.25 të Rregullores së Prokurimit Publik⁴¹. Procesi i fazës pas tenderuese, bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik, i referohet “administrimit të implementimit të kontratave nga ana e AK nëpërmjet modulit për fazën pas tenderuese në sistemin e prokurimit elektronik”.

Nëntë (9) nga 27 tenderët janë monitoruar me fokus në fazën pas tenderuese. Në njërin nga tenderët e përzgjedhur për monitorim të fazës pas tenderuese nuk ka arritur të nënshkruhet kontrata edhe pse tenderi ishte hapur më 16.09.2022 dhe njoftimi për dhënie të kontratës ishte bërë më 14.04.2023. Nga tetë kontratat e monitoruara, katër kanë qenë kontrata për furnizim dhe katër të tjera për punë.

4.1. Vonesa në realizim të punëve

Një nga shkeljet më të shpeshta të evidentuara gjatë monitorimit të fazës pas tenderuese ishin vonesat në realizim të punëve apo në furnizim. Derisa te vonesat në realizim të punëve kryesisht “fajtorë” ishin kushtet atmosferike apo punët e paplanifikuara, në furnizim kishte më shumë vonesa disaditore të porosive të caktuara.

Për shembull, në tenderin e Komunës së Suharekës për

“ndërtimin e shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtjen e tyre”⁴¹, kishte vonesa në realizim të punëve. Pas analizimit të planit të menaxhimit, projekti në fjalë ka filluar të implementohet më 07.12.2022 dhe është planifikuar të përfundojnë me 08.02.2023. Mirëpo, punimet sipas planit të fazës pas tenderuese përfunduan realisht më datën 07.04.2023, saktësisht 60 ditë më vonë se që ishte planifikuar.

BIRN dhe D+ kanë pasur qasje në raportin përfundimtar të menaxherit të kontratës, i cili për këto vonesa kishte thënë se “punimet nuk janë përfunduar për shkak të kushteve atmosferike - prurjet e mëdha të lumenjve”. Duke marrë parasysh natyrën e këtij projekti, pra pastrimin e lumenjve, është e pritshme që një kontratë e tillë të ketë vonesa nëse zbatimi i saj fillon në muajin dhjetor dhe planifikohet që të përfundojë deri në muajin shkurt, pra tre muajt e sezonit të dimrit. Komunitat duhet të kujdesen që për projekte të tilla që lidhen direkt me kushtet atmosferike të synohet që kontrata të fillojë zbatimin gjatë muajve të verës kur ka më pak reshje.

Vonesa në realizim të punimeve sipas dinamikës së paraparë kishte edhe në zbatimin e kontratës: “Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit-ritenderim”⁴² në Komunën e Rahovecit. Kontrata në vlerë 3.8 milionë euro me Grupin e OE-ve “FAMIS-CO” ShA dhe NPT “Bamirs” është nënshkruar më 14.12.2022. Në planin për fazën pas tenderuese thuhet se punët kanë filluar me 23.01.2023 ndërsa pritet që kontrata të përmbillet më 30.07.2025.

Në planin për fazën pas tenderuese janë dhënë fare pak detaje sa i përket procesit të fazës pas tenderuese. Në këtë plan është cekur se fillimi i punëve është bërë më 21.01.2023, ndërsa përfundimi i punëve planifikohet të bëhet më 30.07.2025. Përveç kësaj rubrike, është plotësuar edhe sigurimi i tenderit që është bërë

⁴¹ Tenderi “Ndërtimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja e tyre” Nr.prokurimit:624-22-3252-5-2-1

⁴² Tenderi “Ndërtimi i sheshit të qytetit” Nr.prokurimit: 623-22-6778-5-1-1

më 10.01.2023, ndërsa garancia e përformancës ishte në vlerë prej 381,734 euro, me një kohëzgjatje prej 990 ditëve. Të gjitha rubrikat e tjera që janë në shabllonin e KRPP-së për “Planin e fazës pas tenderuese (PMK)” nuk janë plotësuar.

BIRN dhe D+ përveç qasjes në dokumentet për fazën pas tenderuese e ka vizituar edhe vendpunishten dhe është takuar me mbikëqyrësin e projektit, Albnor Mullaabazi dhe menaxheren e kontratës Diellza Çanta. Ata e kanë pranuar se në fillim kishte vonesa në realizim të punëve, kryesisht për shkak të kushteve atmosferike. Sipas tyre, vonesat janë deri në një muaj.

Po ashtu, sipas menaxherit të kontratës, gjatë punimeve punëkryesi e kishte dëmtuar një gyp të ujit FI350, për të cilin para fillimit të punëve kishin pranuar informacione të pasakta sa i përket thellësisë së tij.

Edhe pse punët në ndërtim të sheshit në Rahovec kanë filluar, aty nuk janë përfunduar të gjitha punët me shpronësim të pronave. Mbikëqyrësi Albnor Mullaabazi ka thënë se deri më tani nuk kanë pasur asnjë zvarritje të punëve për shkak të kontesteve pronësore. Sipas tij, tek pjesa e tregut punimet pritet të fillojnë vitin e ardhshëm, e në atë pjesë janë disa prona që do të këmbehen me komunën. Ky vendim pritet të kalojë përmes Kuvendit Komunal të Rahovecit. Këmbimi një herë ishte miratuar në Kuvendin Komunal, por vendimi ishte kthyer mbrapa nga Ministria me arsyetimin se është i kundërligjshëm meqë Komuna e Rahovecit ende nuk e kishte të miratuar hartën zonale.

Përveç shpronësimeve, për realizim të punëve kanë dalë edhe dy pengesa të tjera, një pikë e shitjes së karburanteve dhe një trafo e rrymës në ponësi të KEDS-it. Këta të fundit i kanë dhënë zgjidhje teknike për zhvendosjen e trafos dhe zëvendësimin e rrejtës, por kanë thënë se këtë investim nuk e kanë paraparë në planin 5-vjeçar të investimeve. Komuna e Rahovecit është obliguar të hapë një tender të ri për të kontraktuar një kompani që do të bëjë zhvendosjen e trafos. Tenderin me vlerë të parashikuar prej 83,162 eurove e kishte hapur më 16.06.2023, por i njëjti është bllokuar

pasi një OE është ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit.⁴³

Deri më tani, bazuar në dokumentet e analizuara dhe takimet me menaxherët e kontratave, rezultojnë që janë përfunduar punët e parapara në situacionin e parë dhe për këtë janë paguar 130,305 euro.

Sa i përket realizimit të punëve tek pjesa e parkingut, është bërë ndërrimi i një pozicioni për të mundësuar ndërtimin e një muri, i cili nuk ishte paraparë në kontratë. Ndërrimet janë bërë me miratim të kompanisë projektuese dhe kryetarit të Komunës së Rahovecit.

BIRN dhe D+ ka evidentuar ndërrimin e pozicioneve edhe në vendimin e datës 27.03.2023 të kryetarit të Komunës së Rahovecit për ndërtimin e murit mbrojtës. Pozicionet që janë ndërruar janë 2.1 deri në 2.5 lidhur me punët e dheut dhe mbushjen, pastaj 3.1 deri 3.11 te punët e betonit dhe 4.1 te punët e armaturës.⁴⁴

4.2. Defektet në projektim

Komuna e Gjilanit e kishte nënshkruar një kontratë në vlerë 246,296 euro me GOE “AAB Constructions SH.P.K.; Eco Holding Group SH.P.K” për “Ndërtimin e Parkut Baja – Ritenderim”⁴⁵. Punimet në këtë projekt kishin filluar në muajin mars të vitit 2023, ekipi i BIRN dhe D+ disa herë e kishte vizituar vendpunishten gjatë realizimit të këtij projekti.

Qysh në fillimin e punëve, janë evidentuar lëshimet në hartimin e projektit ekzekutiv. Pas vizitave në terren ka rezultuar se projektuesi kishte paraparë hyrje në park në një pozitë që kishte pjerrtësi të madhe, që e bënte të pamundur realizimin e projektit siç ishte i paraparë në projekt. Për shkak se pjerrtësia e terrenit ka qenë shumë e lartë dhe për këtë është dashur që hyrja e parkut të zhvendoset për disa metra në të majtë.

Një problem i ngjashëm është hasur edhe te pjesa ku do të ndërtohet amfiteatri i parkut. Sipas menaxherit

⁴³ Intervistë menaxheri i kontratës Diellza Çanta dhe mbikëqyrës Albnor Mullaabazi 21.06.2023

⁴⁴ Intervistë menaxheri i kontratës Diellza Çanta dhe mbikëqyrës Albnor Mullaabazi 03.08.2023

⁴⁵ Tenderi “Ndërtimi i Parkut Baja - Ri Tender” Nr.prokurimit: 651-22-11519-5-2-1

të kontratës, te kjo pjesë është dashur që të gërmohet dhe të largohet më shumë djerrinë se sa ka qenë e përcaktuar në paramasë, gjë që ka shkaktuar kosto shtesë.⁴⁶ Projekti për këtë park është hartuar në vitin 2019, nga kompania “PRO ING Desing & Partners”, ndërsa Komuna e Gjilanit nuk ka dhënë ndonjë informacion se çfarë masa janë ndërmarrë ndaj projektuesit për një planifikim të tillë që e ka obliguar komunën ta ndryshojë projektin.

Qysh në fillim të realizimit të punëve, menaxheri i kontratës e ka ngritur problemin e pranisë së tri shtyllave elektrike të tensionit të lartë të KEDS/KOSTT në hapësirën e parkut. Ato kanë qenë të vendosura aty edhe para se të hartohet projekti, por gjatë hartimit të projektit nuk është paraparë ndonjë zgjidhje për to. Edhe pasi ka filluar ndërtimi i parkut, largimi i këtyre shtyllave nuk është bërë. Sipas menaxherit të kontratës, Komuna e Gjilanit ka dorëzuar kërkesën në KEDS për largimin e tyre, por nuk ka marrë një përgjigje konkrete.

Menaxheri ka thënë se afër këtij parku është një trafo e KEDS-it, që i bie se furnizimi kryesor me energji elektrike kalon nëpër këto shtylla që gjenden në park. Ndërtimi i parkut ka vazhduar përkundër faktit se nuk është bërë asnjë zgjidhje për largimin e shtyllave elektrike. Përveç kësaj, në park është e vendosur edhe një antenë e IPKO-s. Menaxheri ka bërë të ditur se kanë bërë kërkesë në kompani për largimin e asaj antene duke i dhënë kohë 90 ditë për të larguar atë. Gjatë vizitës në vendpunishte, më 3 gusht 2023, nga menaxheri i kontratës jemi njoftuar se ky afat nuk është respektuar dhe se Inspeksioni i Komunës i ka dhënë afat edhe disa ditë shtesë kompanisë për largimin e antenës. Si konkludim, zhvendosja e antenës mbetet në kompetencë të Inspeksionit.⁴⁷

Pas analizës së kontratës dhe vizitave në terren është vërejtur se në park nuk është planifikuar ndërtimi i një toaleti publik, ndërtimi i pushimoreve të mbuluara si dhe pjerrinave e shtigjeve për persona me aftësi të kufizuara.

4.3. Loja me çmime të ulëta e produkte të panevojshme

Më 13.10.2022, Komuna e Pejës ka hapur tender për furnizim me material higjienik dhe ushqimor për nevojat e shkollave dhe çerdheve. Komuna ka bërë një listë të gjatë të produkteve për të cilat ka kërkuar çmime, prej produkteve ushqimore, atyre higjienike e madje edhe pajisjeve elektrike. Të gjitha këto produkte janë futur në një kontratë që është nënshkruar me kompaninë “D.P.T. TEFI” në vlerë prej 149,594 euro.

BIRN dhe D+ i ka pranuar porositë, faturat dhe pagesat që janë bërë që nga nënshkrimi i kontratës e deri më 16.03.2023. Në bazë të faturave, nga gjithsej 98 pozicione sa janë kontraktuar, evidentohet se janë porositur material higjienik dhe ushqimor në 71 pozicione me një vlerë të përgjithshme prej 24,268.80 euro. Ndonëse kontrata është 2-vjeçare me vlerë të përgjithshme 149,594 euro, deri në këtë periudhë shuma e porosive kalon 16 për qind të shfrytëzimit të saj.

BIRN dhe D+ i ka analizuar produktet që ende nuk janë porositur dhe disa prej tyre kanë çmime nën çmimin e tregut. Për shembull, Komuna e Pejës i ka kontaktuar që t'i blejë 1,000 pako me nga 100 piruna të plastikës për vetëm tre centë pakon por deri më tani nuk e ka porositur asnjë të tillë. Po ashtu, nuk është porositur asnjë mbulesë tavoline në gjatësi dy metra, të cilat janë kontraktuar me vetëm 6 centë për copë që për 500 copa është paraparë të shpenzohen 30 euro. Nuk është porositur asnjë zbutës rrobash, që ishte kontraktuar me çmim 0.95 për copë apo 30 euro për 500 të tilla. Deri më tani nuk është porositur asnjë poç elektrik 100 dhe 50 vat, që ishin kontraktuar me çmim 30 centë për copë.

Ndërsa disa nga produktet ushqimore që nuk janë porositur deri më tash janë: avokado të kontraktuara me çmim 1 euro për kilogram, kivi me çmim 50 centë për kilogram, domate të kontraktuara me çmim prej 30 centë për kilogram, portokall me çmim 50 centë për kilogram, qumësht tetrapak 0.50L 2.8% me çmim 30 centë për copë, ananas me çmim 35 centë për kilogram.

⁴⁶ Intervistë me menaxherin e kontratës, Taulant Maliqi.

⁴⁷ Intervistë me menaxherin e kontratës, Taulant Maliqi, 3 gusht 2023.

Pas analizës së porosive të bëra, rezultojnë se në disa prej pozicioneve pothuajse është konsumuar sasia e paraparë në kontratë. Për shembull, deri më tash janë porositur 414 xhokerë - katrorë, nga 500 copë sa është paraparë të blihen me një çmim 1.95 euro copa. E në pesë pozicione të kësaj kontrate u porositën më shumë mallra se sa sasia e kontraktuar. Në pozicionin 6, shampon për dysheme me çmim 1.50 euro u kontraktuan 400 litra, ndërsa sasia e porositur e këtij lloj shamponi ishte 1,191 litra. Njëjtë edhe në pozicionin 10, paloma higjienike 1/100 janë kontraktuar 1,000 copë me çmim 35 centë, ndërsa sasia e porositur është 1,509 copë, apo tejkalim i sasisë rreth 151 për qind.

Sasia e porositur në raport me atë të kontraktuar është tejkaluar edhe tek pozicioni 24 - Letër rollne kuzhine 1/10 450 copë me çmim 45 centë, ndërsa janë porositur 1,278 copë, që si përqindje i bie 284%. Tek pozicioni 27 - zbardhues 1/1 me çmim 98 centë, janë kontraktuar 300 litra, ndërsa janë porositur 840 sosh apo 280%. Si dhe te pozicioni 57 - sallatë e gjelbër 1/1 janë kontraktuar 500 kilogramë me çmim 5 centë ndërsa janë porositur 80 kilogramë apo 150% e sasisë së kontraktuar.

Sipas trendit të furnizimit, vihen në pah mangësi dhe planifikim jo i duhur, ndërsa kontrata në fjalë rrezikon të shpenzohet para afatit të përcaktuar. Madje, menaxheri i kontratës ka thënë se kontrata mund të konsumohet para se të arrihet afati kalendarik i përfundimit të saj pasi shumë shpejt do të fillojnë punën edhe dy çerdhe të reja në qytetin e Pejës.

4.4. Vit pas viti: Lidhja e kontratës me çmime abnormalisht të ulëta

Më 21.11.2022, Komuna e Gjakovës ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin "Furnizim me material të shtypur zyrtar-Kontratë dy vjeçare"⁴⁸, me numër të prokurimit [632-22-13150-1-1-1](#). Për këtë tender është përdorur procedura e hapur e prokurimit me kriter për dhënie të kontratës, çmimi më i ulët. Vlera e parashikuar për këtë kontratë është 220,000 euro. Ky projekt është pjesë e Planit të Prokurimit të Komunës së Gjakovës.

Përkundër faktit që ishte pjesë e planit të prokurimit, Komuna nuk e kishte respektuar afatin minimal të përcaktuar me ligj për pranimin e tenderëve lidhur me furnizim me material të shtypur dhe zyrtarë - kontratë dyvjeçare, nën arsyetimin që mos të mbeten pa material. Në bazë të Rregullores për prokurim, për kontratat me vlerë të mesme afati është jo më pak se 20 ditë, ndërsa për kontrata me vlerë të madhe jo më pak se 40 ditë. Kontrata në fjalë është e madhe. Se afati për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar thuhet edhe në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Për këtë tender, Komuna e Gjakovës kishte pranuar katër oferta. Kompania "Erpo-Print" kishte ofertuar me 116,135 euro, kompania "Europrinty" kishte ofertuar me 139,887 euro, "Blendi OP" me 198,557 euro dhe kompania "Agimi-De" kishte ofertuar me 194,544 euro.

Komuna e Gjakovës e kishte rekomanduar për kontratë kompaninë "ERPO-PRINT" ShPK, e cila kishte ofertuar 116,135 euro. Kundër këtij njoftimi nuk ishte ankuar asnjë kompani, duke i hapur rrugë Komunës së Gjakovës që të nënshkruajë kontratën më 15.02.2023. Menaxheri i kontratës së këtij tenderi është emëruar Ideal Kushumlija⁴⁹, i cili me profesion është ekonomist.

E njëjta kompani, i kishte fituar edhe dy kontratat e kaluara për të njëjtin furnizim. Në bazë të hulumtimeve, rezultojnë se kompania në fjalë ka nënshkruar edhe dy kontrata, një në vitin 2019 dhe tjetrën në vitin 2021.

Në kontratën e vitit 2019, Komuna e Gjakovës kishte kërkuar oferta për plot 107 pozicione. Pas analizimit të porosive që kanë bërë bazuar në atë kontratë, rezultojnë se nga 107 pozicione në total që kanë qenë në kontratë, Komuna e Gjakovës ka porositur vetëm 45 të tilla, ndërsa 62 pozicione që kanë qenë kryesisht me çmime jo-normalisht të ulëta nuk janë porositur fare. Nga 62 pozicione që nuk janë porositur, 32 prej tyre janë me çmim të kontraktuar prej vetëm 1 cent.

Kompania "Erpo - Print" është zotuar që të kryejë shërbimin "Tapeta me montim" me vetëm 1 cent për një metër katror apo 6 euro për 600 metra katrorë, aq sa është sasia e kërkuar me kontratë. "Erpo-Print"

⁴⁸ Tenderi "Furnizim me material të shtypur zyrtar-Kontratë dy vjeçare", Nr.prokurimit:632-22-13150-1-1-1

⁴⁹ BIRN dhe D+ kanë provuar disa herë të realizojnë intervistë me menxherin Ideal Kushumlija, mirëpo nuk ka pranuar.

është kontraktuar që të furnizojë Komunën e Gjakovës me “Fasiklla të formatit A3, me plastifikim me peshë 350gr”, për vetëm 1 cent. Për këtë pozicion nuk ka pasur asnjë porosi nga ana e Komunës së Gjakovës. Për dallim nga fasikllat e formatit A3 ku është ofertuar me 1 cent, për produktin “Fasiklla të formatit A4, me plastifikim me peshë 350gr”, “Erpo-Print” ka ofertuar me çmimin 50 centë për copë. Komuna i kishte kontraktuar 1,000 copa fasiklla të tilla, por në fund i ka porositur 4,450 në vlerë 2,275 euro. Pra, vetëm për këtë pozicion ka shpenzuar 1,275 euro më shumë se sa që ishte planifikuar. Çmime jo-normalisht të ulëta për pozicione ishin kontraktuar edhe në kontratën e vitit 2021. BIRN dhe D+ e kanë analizuar edhe kontratën aktuale, atë të nënshkruar më 15.02.2023.

Pozicione me çmim 1 cent janë evidentuar edhe në kontratën aktuale që është lidhur më 15.02.2023. Në pozicionin 12 dhe 13: Fotokopje A4 bardh e zi dhe Fotokopje A4 color, janë kontraktuar çmime me 1 cent. Ndërsa me 2 centë ato të formatit A3. Me çmime prej 1 cent janë kontraktuar edhe formularë A4 dhe vizitë-karta, zarfa me llogo të formatit A4, A5, dhe A3.

10 nga 119 pozicionet janë kontraktuar me çmim prej 1 cent, 8 pozicione janë kontraktuar me 2 centë, 2 pozicione me 3 centë dhe 6 pozicione me 5 centë. Pra, 28 pozicione të kërkuara janë kontraktuar 5 centë apo më lirë. E një nga pozicionet me çmim jo-normalisht të ulët është edhe “Dizajnimi dhe printimi i revistës Gjakova Press A4 brendia 44 faqe bardh dhe zi, kopertinat color (130gr)”⁵⁰. 9.500 copa revista janë kontraktuar për 950 euro apo 10 centë copa.

BIRN dhe D+ i kanë pranuar porositë dhe pagesat që janë bërë nga nënshkrimi i kontratës e deri më 04.04.2023. Në bazë të faturave, nga gjithsej 119 pozicione sa janë kontraktuar, evidentohet se janë porositur material zyrtar në 13 pozicione me një vlerë prej 7,919 euro.

Ndonëse kontrata është dyvjeçare, në bazë faturave, pozicionet 117, 118 dhe 119, të cilat kanë të bëjnë me furnizim me kupa dhe medalje me ngjyrë ari dhe argjendi është përmbushur plotësisht vlera e parashikuar. Në pozicionin 117 është paraparë furnizimi me 84 kupa

për garat shkollore sportive me një çmim prej 20 euro copën. Deri më datën 03.03.2023, në bazë të faturave janë porositur 84 kupa në vlerë prej 1,680 euro. Kurse në pozicionin 118 dhe 119 ishin paraparë blerja e 1,380 medaljeve me një çmim prej 2 euro copa. Deri më 03.03.2023, janë porositur 1,380 medalje me një çmim prej 2,760 euro.

Në pozicionin 12, Fotokopje A4 bardh e zi nga 50,000 sa janë kontraktuar me çmim 1 cent për dy vite, janë porositur 3,000 copë, apo 6 për qind e tyre. Tek pozicioni 14 - “Fotokopje A3 color” janë porositur 4,500 apo 90% nga 5,000 sa kanë qenë të kontraktuara me çmim 2 centë, ndërsa në pozicioni 15 - “Fotokopje A3” bardh e zi nga 10,000 sa janë kontraktuar me çmim 2 centë, janë porositur 4,500 apo 45% e sasisë së kontraktuar.

Në nivelin e 50% është shfrytëzuar edhe pozicioni 52 i paramasës, për formular A4, ku nga 40 mijë sa kanë qenë të kontraktuara, janë furnizuar me gjithsej 20 mijë, me çmim 1 cent.

Tejkalim të sasisë së blerë në raport me atë të kontraktuar pati tek pozicioni 55 i paramasës - blloka A4 NCR me ngjyra të ndryshme 4 kope (100 fletë), me çmim 3 euro, ku janë kontraktuar gjithsej 100 copë, ndërsa janë blerë 145 copë.

50 Tenderi “Furnizim me material të shtypur zyrtar-Kontratë dy vjeçare”, Nr.prokurimit:632-22-13150-1-1

5. Ankimimi

Ligji i Prokurimit Publik i ka mundësuar OE-të që të ankohen në dy shkallë, fillimisht përmes kërkesës për rishqyrtim të AK-të, e më pas edhe në Organin Shqyrtues të Prokurimit. OE-të zakonisht i shfrytëzojnë të drejtat e ankesës kurdo që ata kanë bindjen që janë bërë shkelje ligjore në një proces të prokurimit.

Nga 27 tenderët, në 15 tenderë kishte korrigjime të gabimeve. Në disa prej tenderëve kishte më shumë se një korrigjim, e madje kishte deri në gjashtë korrigjime të bëra. Këto korrigjime janë bërë pas pyetjeve dhe sqarimeve të kërkuara nga OE, pas gabimeve që i kanë evidentuar vetë AK-të, si dhe pas kërkesave për rishqyrtim. Numri i madh i korrigjimeve është tregues se disa prej AK-ve duke i miratuar kërkesat për rishqyrtim e parandalojnë një ankesë që të shkojë në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Përkundër kësaj, numri i ankesave në OSHP prapë është i madh, sidomos për shkeljet e pretenduara gjatë vlerësimit të ofertave.

Për 13 nga 27 tenderët e monitoruar apo në 48% prej tyre ka pasur ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Nga 13 tenderët që ishin në shqyrtim në OSHP, në 8 prej tyre kishte dy e më shumë ankesa. Në një tender ishin bërë deri në gjashtë ankesa. Kishte tender që kishte shkuar më shumë se dy herë në OSHP dhe kishte raste kur një operator për të njëjtin tender ishte ankuar dy herë në OSHP, në dy momente të ndryshme. Në total, për këta 13 tenderë që ishin shqyrtuar në OSHP ishin bërë 32 ankesa.

Nga 32 ankesat e pranuar, 15 ishin refuzuar si të pabazuara, të pasafatshme apo të palejuara. Ndërsa, në 13 prej tyre ishin aprovuar pretendimet e OE dhe tenderët ishin kthyer në rivlerësim apo përmirësim të Dosjes së Tenderit. Katër nga tenderët ende janë në shqyrtim, pra katër ankesa ende janë në proces e sipër në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Kjo e fundit në 13 raste ka gjetur shkelje ligjore në vendimet e lëshuara nga AK-të, duke i kthyer tenderët në rivlerësim apo ritenderim. Nga analiza e procesit të ankimimit rezultoi që AK-të kanë filluar të marrin parasysh Kërkesat për rishqyrtim që bëhet në fazën e para-tenderimit, pra për kriteret teknike apo profesionale të kërkuara. AK-të i kanë parandaluar ankimimet në OSHP duke i aprovuar Kërkesat për rishqyrtim dhe duke i korrigjuar njoftimet dhe dosjet e tenderit.

Mirëpo, AK-të janë shumë më të ngurta kur vjen puna të shqyrtimi i ankesave që bëhen pas vlerësimit të ofertave, pasi ato që i kanë refuzuar kërkesat për rishqyrtim kanë lejuar që 32 ankesa të bëhen për 13 tenderët e monitoruar.

Në bazë të analizës së vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit rezultoi që AK-të numrin më të madh të shkeljeve ligjore e bëjnë gjatë vlerësimit të ofertave të OE. Nga 13 rastet kur Gjykata e Tenderëve kishte gjetur shkelje ligjore, 12 prej tyre ishin në procesin e vlerësimit të ofertave. Vetëm në njërin nga vendimet, OSHP-ja kishte konstatuar se janë bërë shkelje ligjore gjatë fazës së para-tenderimit duke e detyruar AK që të ndryshojë Dosjen e Tenderit.

Numri i ankesave të shqyrtuar nga OSHP

32

ankesa në total

Në 40% të ankesave, OSHP ka gjetur shkelje ligjore nga AK

40%



13

ankesa të OE
aprovohen

15

ankesa e OE
refuzohen të
pabazuara, të
pasafatshme apo
të palejuara

4

ankesa në
proces

6. Ministria e Shëndetësisë

6.1. Mirëmbajtja e 70% të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) - Faza e paratenderimit

Më 7 mars 2023, MSh ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin “Mirëmbajtja e 70% të HW të SISH-it për Institucionet Shëndetësore”⁵¹, me numër të prokurimit 206-23-1650-2-1-1. Në kuadër të projektit për monitorim të tenderëve që BIRN e ka së bashku me D+, ky projekt është përzgjedhur për monitorim të procesit të para-tenderimit.

Ky tender është pjesë e planit të prokurimit të MSh-së për vitin 2023. Vlera e parashikuar e tenderit dhe ajo në planin e prokurimit është e njëjtë, 720 mijë euro dhe më 27 shkurt 2023 është lëshuar disponueshmëria e fondeve nga Zyrtari Kryesor Financiar. MSh është ndër autoritetet e pakta që ka treguar emrat e personave që i kanë hartuar specifikacionet teknike për këtë tender.

Përmes këtij tenderi, MSh synon mirëmbajtjen 3-vjeçare harduerike dhe të shërbimit të infrastrukturës të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), pjesës aktive dhe pasive, e cila është e shtrirë në 70% të institucioneve shëndetësore. Mirëmbajtja harduerike dhe e shërbimit, sipas MSh-së, duhet të sigurojë funksionimin pa probleme dhe pa ndërprerje të pajisjeve në përdorim.

Tenderi i shpallur në vitin 2023 parasheh mirëmbajtjen e infrastrukturës së SISH që ishte realizuar në vitet e mëhershme nga kompania që ishte rekomanduar për kontratë. MSh përmes një tjetër tenderi “Zgjerimi i Infrastrukturës ekzistuese për SISH”⁵², në vitin 2018 kishte blerë pajisjet për Sistemin Informativ Shëndetësor. Tenderi e kishte vlerën 4.6 milionë euro dhe ishin

blerë pajisjet e quajtura “Zero Clients”. Këto pajisje, sipas Ministrisë, ishin shpërndarë në shumicën e institucioneve të parapara, përveç në QKUK.

Pasi nuk ishin futur në funksion, në mungesë të softuerit dhe pasi iu kishte kaluar garancioni, MSh ka hapur tenderin e vitit 2023, sipas udhëheqësit të IT-së, Zenel Hisenaj, me synimin për krijimin e softuerit, marrjen e garancionit për pajisjet nga distributori, si dhe futjen në funksion të tyre. Tenderin e vitit 2018 e kishte fituar po e njëjta kompani që i është dhënë tenderi në vitin 2023, kompania “Infosoftware Systems”.

Afati për dorëzimin e ofertave nga OE ka qenë deri më 17 prill 2023, duke respektuar kështu afatin ligjor prej 40 ditëve. Vlera e parashikuar e këtij tenderi ka qenë 720 mijë euro.

Edhe pse dosjen e tenderit e kishin shkarkuar 49 OE, në fund, ka ofertuar vetëm njëri nga ta. Të njëjtin operator, pra të vetmin që ka aplikuar, Komisioni vlerësues e ka rekomanduar që t’i jepet kontrata. OE “InfoSoft” kishte ofertuar me një çmim prej 715,999 euro, apo vetëm 4 mijë e 1 euro më lirë se sa çmimi i parashikuar nga ana e Ministrisë.

Tenderi i vitit 2023

Në specifikat e tenderit të shpallur më 17 prill 2023, MSh ka kërkuar që OE duhet të ketë së paku statusin e partnerit në “VMware, DellEmc dhe CISCO” për arsye se, sipas ministrisë⁵³, të gjitha pajisjet e blera në vitin 2018 janë të kësaj teknologjie.

51 Tenderi “Mirëmbajtja e 70% të HW të SISH-it për Institucionet Shëndetësore”, Nr. prokurimit:206-23-1650-2-1-1

52 Tenderi “Zgjerimi i Infrastrukturës ekzistuese për SISH”

53 Intervistë në Zyren e Prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë me Berat Marmullaku - udhëheqës i prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë, Zenel Hisenaj - udhëheqës i IT në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Gjylferije Zabeli nga zyra për Media. 7 korrik 2023 në ora 10:00.

Është kërkuar gjithashtu që në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, OE të ketë realizuar minimumi dy projekte të natyrës komplekse me “Cisco, VMëare dhe DellEmc”, duke mos e vendosur fjalën ‘ekuivalente’, siç e kërkon ligji. Për shkak të pajisjeve që janë të markave të cekura, në një rën prej specifikave Ministria ka kërkuar që edhe stafi të jetë i certifikuar në Cisco dhe VMëare, të cilat po ashtu i ka shkruar pa përmendur fjalën ‘ekuivalente’.

BIRN dhe D+ përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike, e ka siguruar kërkesën dhe pyetjet sqaruese dhe emrat e OE-të që i kanë bërë ato për këtë proces të prokurimit.

Në mesin e pyetjeve/kërkesave, është edhe ajo e OE “Techbase”, i cili ka kërkuar nga MSh që të largojë citimin e markave nga dosja e tenderit dhe të lejojë edhe marka të tjera që janë po aq të specializuara në teknologjinë dhe fushën e kërkuar. Por, Ministria nuk e ka miratuar një kërkesë të tillë. Më pas, e njëjta kompani nuk ka ofertuar në këtë tender.

Një tjetër dilemë e ngritur gjatë fazës së tenderimit ka qenë nëse është e obligueshme që prodhuesi të ofrojë garanci për pajisjet apo mjafton vetëm OE. Madje, një nga OE “Ntp Online”, në kërkesën e tyre, ka dhënë shpjegime që për Kosovë prodhuesit nuk ofrojnë garanci të tilla. Përkundër shpjegimeve nga “Ntp Online”, por edhe nga dy OE-të të tjerë “Techbase” dhe “Cactus”, për të njëjtën çështje MSh ka thënë se garancitë duhet t’i japë prodhuesi.

BIRN dhe D+ kanë pasur qasje në ofertën e dorëzuar në MSh nga kompania “Infosoft Systems”. Kjo kompani nuk ka dorëzuar referencë për projektin “Zgjerimi i Infrastrukturës ekzistuese për SISH”, të cilin e kishte realizuar në MSh. Projekti në fjalë është realizuar në vitin 2018, ndërsa tash, në vitin 2023, kanë aplikuar në tender për të mirëmbajtur pajisjet e vendosura në atë kohë. Për projektin “Zgjerimi i Infrastrukturës ekzistuese për SISH”, kompania “Infosoft Systems”

kishte dorëzuar vetëm dokumente të pranimit të punëve të realizuara, por jo edhe referencë.

Edhe në Dosjen e Tenderit, MSh nuk ka kërkuar vetëm referencat si dëshmi se OE ka realizuar të paktën dy (2) projekte të natyrës komplekse me Cisco, VMware, dellEMC Zero Clients.

“Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfutjesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve”, thuhet në njoftimin për kontratë për këtë tender.

Një nga kërkesat po ashtu ka qenë që garancioni për pajisjet që tashmë janë të blera të dëshmohet direkt nga prodhuesi. E më vonë është lejuar që garancioni të sigurohet edhe përmes distributorit të autorizuar. Zyrtari i IT-së dhe i prokurimit kanë thënë se mundësia e sigurimit të garancionit përmes distributorit të autorizuar ka hapur konkurrencën, por përkundër kësaj të fundit, MSh e ka pranuar vetëm një ofertë.

BIRN dhe D+ kanë biseduar me OE-të sa i përket mundësisë që të aplikojnë edhe me distributorin e autorizuar, por OE-të kanë thënë se çmimi që ofrojnë distributorët e autorizuar dallon nga një OE te tjetri. Sipas tyre, ata zakonisht pranojnë çmime më të larta nga distributorët dhe kështu është distributori ai që e vendos në fund se kush e fiton një tender, sidomos në rastet e tilla kur kriteret e tenderit janë kufizuese⁵⁴.

Njoftimi për dhënien e kontratës për kompaninë “Infosoft Systems” është publikuar më 2 qershor 2023. Por më 16 gusht 2023, AK-ja ka njoftuar se ka anuluar⁵⁵ procedurën e prokurimit. Arsyeja për anulimin e kësaj procedure, është se pas një Raporti të ekspertëve të Bankës Botërore, është konstatuar se disa kërkesa kanë qenë të panevojshme kufizuese. Në arsyetim përmendet edhe fakti se në tender ka pasur vetëm një ofertues, në ndërkohë ka pasur shumë OE-të që e kanë shkarkuar dosjen e tenderit.

⁵⁴ Intervistë me menaxher të njëres nga kompanive që e ka shkarkuar dosjen e tenderit por që në fund nuk ka ofertuar në këtë tender të Ministrisë së Shëndetësisë.

⁵⁵ Tenderi “[Mirëmbajtja e 70% te HW te SISH-it për Institucionet Shëndetësore](#)”, Nr. prokurimit: 206-23-1650-2-1-1

Në arsyetimin për kërkesën për anulimin e aktivitetit të prokurimit, Sekretari i MSh-së, Naim Bardiqi, duke cituar raportin e ekspertëve të Bankës Botërore, ka përmendur kërkesën që “kompania duhet të dëshmojë se në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontrata ka realizuar të paktën dy projekte të natyrës komplekse me Cisco, VMware, dell EMC Zero Clients”, që është konstatuar se është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

Por, bazuar në nenin 26.8 të Rregullorës së Prokurimit Publik, AK i lejohej që të përcaktojë numrin e referencave duke përfshirë caktimin e minimumit të referencave që duhet të dorëzohen nga OE në një aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu, Sekretari i MSh-së ka përmendur edhe kërkesën për stafin, për të cilin sipas kërkesës në dosjen e tenderit, është dashur që të ketë inxhinierë të certifikuar me CCNP në Cisco dhe VMware e sipas tij, duke cituar raportin e ekspertëve, nuk janë në harmoni me procedurat e kontratës së vitit 2018. Një kërkesë tjetër e pazakontë sipas Sekretarit, ka qenë edhe kërkesa për vazhdimin e garancionit, duke konsideruar se një kërkesë e tillë nuk është standarde në procedurat e prokurimit, sepse një gjë e tillë është shumë e vështirë të ofrohet nga një OE tjetër përveç atij që ka bërë furnizimin fillimisht.

Më 17 gusht 2023, BIRN dhe D+ kanë kërkuar qasje në raportin e ekspertëve të Bankës Botërore dhe në vendimin e sekretarit të MSh-së. MSh, në përgjigjen e tyre, kanë thënë se raporti i BB-së është i brendshëm dhe se ata duhet të marrin një leje nga Banka Botërore në mënyrë që t’u lejojnë qasje palëve të treta në këtë raport. BIRN dhe D+ ende nuk kanë pranuar raportin e kërkuar.

Bllokimi i tenderit në OSHP

Pas anulimit të tenderit, kompania e rekomanduar për kontratë “Infosoft” është ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Kjo kompani, në mes tjer-



Eksperti i OSHP-së ka thënë se Ministria e Shëndetësisë është dashur që menjëherë pas hapjes së ofertave të alarmohet për faktin që kishte pranuar vetëm një ofertë përkundër që 49 OE ishin interesuar për këtë tender.

ash, pretendon se MSh e ka anuluar këtë tender në mënyrë të kundërligjshme, pasi Ligji i Prokurimit nuk ia mundëson anulimin e tenderit pas përfundimit të të gjitha fazave të prokurimit. Madje, “Infosoft” në ankesën e tyre pretendojnë që tashmë kanë filluar përgatitjet për zbatimin të kontratës, pasi janë rekomanduar për kontratë dhe nuk ka pasur asnjë ankesë dhe kishte mbetur vetëm nënshkrimi formal i kontratës. Eksperti Shqyrtues i caktuar për këtë lëndë nga OSHP-ja ka konstatuar se Sekretari i MSh-së ka të drejtë që mos të nënshkruajë një kontratë, nëse arrin që të argumentojë që janë shkelur parimet bazë të Ligjit të Prokurimit, siç ka ndodhur në këtë tender. Eksperti i OSHP-së ka thënë se MSh është dashur që menjëherë pas hapjes së ofertave të alarmohet për faktin që kishte pranuar vetëm një ofertë përkundër që 49 OE ishin interesuar për këtë tender. Ai në fund i ka rekomanduar “panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së”. Paneli Shqyrtues i OSHP-së ende nuk ka vendosur për ankesën e kompanisë “Infosoft”.

Shkeljet në tenderin me një ofertues të përgjegjshëm

Më 6 shkurt 2023, MSh ka hapur tenderin për “Mirëmbajtjen dhe avancimin e sistemit BHIS”⁵⁶, me numër të prokurimit 206-23-571-2-1-1. Afati i dorëzimit të ofertave

56 Tenderi “[Ritender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit, BHIS”](#)”, Nr. prokurimit:206-23-571-2-1-1

për kompanitë e interesuara për të marrë pjesë në këtë tender ishte deri më 10 mars 2023 në ora 14:00, duke e shkurtuar afatin ligjor nga 40 në 20 ditë, për pranimin e ofertave. Për të njëjtin aktivitet të prokurimit ishte publikuar njoftimi paraprak më 26.01.2023. Në nenin 45 të Rregullores së Prokurimit Publik lejohet shkurtimi i afateve në rastet kur është publikuar një njoftim paraprak, por duhet të kalojnë 40 ditë nga data e publikimit të njoftimit paraprak deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë. Në rastin konkret nga njoftimi paraprak e deri në publikim të njoftimit për kontratë kanë kaluar vetëm 11 ditë.

Prandaj, MSh-së ka dhënë një arsyetim për shkurtimin e afatit. MSh-së ka thënë se një tender i njëjtë kishte dëshuar në vitin 2021 dhe se ka qenë kërkesa emergjente për tenderimin e këtij projekti, pasi sipas tyre, të gjitha shërbimet në nivelin primar dhe me disa shtesa në nivelin sekondar e terciar, janë kruciale për zhvillimin e sistemit të Sigurimit Informativ Shëndetësor, si projekt nacional për sektorin e shëndetësisë.

Vlera e parashikuar e kësaj kontrate ka qenë 1 milion e 80 mijë euro, ndërsa ka qenë kontratë kornizë për tre vjet apo 36 muaj. Në këtë tender kanë ofertuar katër OE-të ndërsa për nënshkrimin e kontratës është rekomanduar kompania “PBC” me çmimin e ofertuar prej 1 milionë e 64 mijë euro, pra vetëm 16 mijë euro më lirë se vlera e parashikuar e kontratës, si dhe duke qenë ofertuesi me çmimin më të lartë.

Në këtë tender kanë ofertuar edhe tre operatorë të tjerë ekonomikë. OE “Oni” kishte ofertuar me 870,840 euro, GEO “TechVison shpk” me 822,240 euro si dhe “GOE Botek & Edusoft & Teched Consulting Service” me 533,124 euro. Të gjithë OE-të e tjerë janë eliminuar (ndër të tjera) për shkak se nuk kanë pasur një projekt të implementuar të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH), në të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë.

Njëra kompani “Logistics”, më 13 shkurt 2023, ka bërë një kërkesë të “kërkesa për sqarime”, duke kërkuar që dëshmitë për projekte të ngjashme të përfunduara me sukses, t’i dëshmojë vetëm me kontrata, e jo me referenca të lëshuara nga insitucioni përkatës. Këtë AK e ka

pranuar, edhe pse kërkesa fillestare në dosjen e tenderit ka qenë prezantimi i referencës apo certifikatës për kryerjen e shërbimeve. E njëjta kompani më pas nuk ka ofertuar në këtë tender. Por, një kontratë e nënshkruar asnjëherë nuk mund të dëshmojë se e njëjta është përfunduar me sukses nga ana e OE. Ka shumë raste kur një kontratë e nënshkruar nuk finalizohet, ka vonesa ose edhe shkëputet tërësisht nga AK-të apo OE.

Por, kompania e rekomanduar për kontratë “PBC”, në ofertën që ka dorëzuar për projektin “Health Information System Patient Registration Application” me MSh, në vlerë 129,576 euro, nuk ka prezantuar një referencë për këtë projekt, por vetëm kontratën dhe disa fatura.

Edhe MSh e ka konfirmuar se “PBC” nuk ka bërë një kërkesë për t’u pajisur me referencë të këtij projekti, edhe pse zyrtari i IT-së në MSh, Zenel Hisenaj, pretendon se e ka kryer me sukses.⁵⁷

Pra, kompania që është rekomanduar për kontratë “PBC” e kishte ndërtuar sistemin për nivelin parësor shëndetësor në vitin 2018, pra platformën softuerike, ndërsa me tenderin e ri që Ministria e ka rekomanduar për kontratë, do të zhvillonte dhe mirëmbante të njëjtin sistem edhe për nivelin dytësor shëndetësor dhe nivelin tretësor.

Për dallim nga tenderi i hapur në vitin 2021, në të cilin ishte kërkuar që OE të ketë përvojë në zhvillimin dhe implementimin e të paktën një projekti për “Health Information System” në nivel vendi, për të paktën njërin nga nivelet e shëndetësisë, në tenderin e vitit 2023 kushti “nivel vendi” është hequr. Ministria ka thënë se kjo është bërë si rrethanë lehtësuese që të mundësojë një konkurrencë më të madhe.

Kundër njoftimit të MSh-së, kompania “Botek” ishte ankuar në OSHP, duke pretenduar se janë bërë shkelje ligjore. “Botek” në këtë tender kishte ofertuar me 533,240 euro, pra kishte një çmim përgjysmë më të lirë se oferta e rekomanduar për kontratë e kompanisë “PBC”.

57 Takimin me udhëheqësin e Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë, Berat Marmullakun dhe zyrtaren për media Gjylferije Zabeli, të datës 7 korrik 2023 në ora 10:00

Pretendimi kryesor i kompanisë ka qenë se referenca për projektin e përfunduar në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, për sistemin informativ për pacientët, ka lidhshmëri të drejtpërdrejtë me sistemin informativ shëndetësor. Por, MSh si v, e kishte refuzuar këtë referencë, me arsyetimin se projekti i referuar nga “Botek” ka të bëjë me menaxhimin e proceseve për rimbursimet buxhetore dhe proceseve të brendshme të Fondit të Sigurimeve, ndërsa referenca e kërkuar nga Ministria i dedikohet pjesës shëndetësore.

OShP ka vendosur që të anulojë vendimin e MSh-së për rekomandim për kontratë të kompanisë “PBC” në vlerë prej 1 milion e 64 mijë euro dhe tenderin ta kthejë në rivlerësim. Paneli Shqyrtues ka kërkuar nga MSh që gjatë rivlerësimit t’i shqyrtojë të gjitha pretendimet e ngritura nga OE ankues.

Sfidat me kontratën për furnizim me barna nga lista esenciale

Më 14 mars 2022, MSh kishte hapur tenderin për ‘Furnizim me barna nga Lista Esenciale’, me numër të prokurimit ‘206-22-1860-1-1’.⁵⁸ Afati i dorëzimit të ofertave për kompanitë e interesuara për të marrë pjesë në këtë tender ishte deri më 25 prill 2022, në përputhje me afatet e rregullta ligjore. Vlera e parashikuar e këtij tenderi ka qenë 350 mijë e 232 euro.

Në njoftimin për kontratë, ministria e ka kufizuar numrin e aplikuesve që do mund të ftohen për të dorëzuar ofertat në gjashtë sosh. Sipas njoftimit, nëse më shumë se gjashtë kandidatë të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve do të riezaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit.

Tenderi është i ndarë në 16 LOT-e, por 5 lloje të këtij tenderi janë anuluar në mungesë të ofertueseve.

OE ‘Imed’ ka fituar LOT-in 4 të tenderit. Operatori ‘Promed’ ka fituar LOT-et 7, 8 dhe 9.

Operatori ‘Brupharm’ ka fituar LOT-et 3 dhe 12 të tenderit. OE ‘Gentipharm’ ka fituar LOT-in 16 të tenderit. Operatori ‘Lirimed’ ka fituar LOT-in 11 të tenderit dhe OE ‘Rona Farm’ ka fituar LOT-in 14 të këtij tenderi.

Nga analiza që BIRN dhe D+ u kanë bërë porosive të kryera nga ana e ministrisë në njërën anë dhe liferimit të produkteve nga kompanitë në anën tjetër, është vërejtur se në të paktën 8 porosi, ka pasur vonesa në liferimin e produktit.

Të gjitha kontratat janë nënshkruar me kushtin se afati kohor për dorëzim të mallit do të jetë maksimumi 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhërblerjes nga ministria. Gjatë monitorimit të menaxhimit të kontratave të këtij tenderi, BIRN dhe D+ kanë gjetur se vonesat janë duke filluar nga një ditë minimumi, deri në 21 ditë maksimumi.

Nga të dhënat e ofruara nga MSh gjatë monitorimit të tenderit nga BIRN dhe D+, OE ‘Brupharm’ në dy raste ka shkaktuar vonesa në liferimin e produktit. Një herë është vonuar për 21 ditë, për produktin ‘Ibuprofen’ me vlerën e faturës prej 16 mijë e 170 euro. Për këtë vonesë, ministria i ka shqiptuar gjobitur në vlerë 849 euro e 93 centë. Herën e dytë është vonuar për 15 ditë, për produktin e njëjtë. Për faturën prej 3 mijë e 921 eurove është gjobitur me 152 e 78 centë.

Operatori ‘Lirimed’ po ashtu ka shkaktuar vonesa dy herë. Një herë për faturën prej 1 mijë e 257 eurove për produktin ‘Paracetamol’ është vonuar 12 ditë dhe është gjobitur 50 euro. Ndërsa herën e dytë është vonuar një ditë për të njëjtin produkt, në faturën në vlerë prej 41.89 euro, është gjobitur për 11 centë.

‘Rona Farm’ në dy raste kishte vonesa në liferim të produkteve. Një herë ka vonuar produktin ‘Desloratidine’ për 6 ditë dhe është gjobitur me 19.16 euro dhe një herë tjetër e ka vonuar të njëjtin produkt 20 ditë dhe është gjobitur 38.12 euro. Fatura e gjobës së parë ka qenë 1 mijë e 257 euro, ndërsa e së dytës ka qenë 724 euro.

58 Tenderi i Ministrisë së Shëndetësisë: [Furnizim me barna nga Lista Esenciale’, me numër të prokurimit ‘206-22-1860-1-1’.](#)

OE 'Promed' gjithashtu në dy raste ka shkaktuar vonesa. Herën e parë është vonuar 6 ditë për liferimin e produktit 'Paracetamol' dhe është gjobitur me 9.37 euro, ndërsa herën e dytë është vonuar 25 ditë për produktin 'Morphine' dhe është gjobitur 31.45 euro.

Sipas MSh-së, penalltitë i kanë të caktuara në bazë të LPP, që për 1 ditë vonesë, shuma e penalltisë është 0.25% e faturës.

Në rast të vonesave të njëpasnjëshme, ministria ka thënë se mund të lëshojnë referenca negative për OE apo edhe ta shkëpusin kontratën.

Aktualisht në procedurë për gjobë është edhe një faturë e OE 'Lirimed'. Pasi që operatori nuk ka liferuar produktin edhe pas dy rikujtimeve. Sipas menaxheres së kontratës, në kërkesën e datës 11 shtator 2023⁵⁹ drejtuar operatorit, që nëse nuk bëhet liferimi në kohën e kërkuar, ndaj operatorit në fjalë do të lëshohet referencë negative, përveç gjobës.

Njëri LOT i këtij tenderi është i anuluar për shkak se njëri OE i rekomanduar për kontratë, është gjetur se ka ofertuar paracetamol me sasi më të vogël, por me çmim më të shtrenjtë në krahasim me një OE tjetër të rekomanduar për një LOT tjetër. Pra për LOT 10 një OE për 'Paracetamol 500 mg' ka ofertuar me 94 centë. Ndërsa, në LOT 11 një OE ka ofertuar me 'paracetamol 1000mg' me 84 centë. LOT 10 i këtij tenderi me OE 'Liri-Med' është anuluar, për shkak se AK (MSh) ka gjetur se produkti 'Paracetamol Injeksion 500 mg sasaia 150 mijë e 780, është vërejtur mospërputhje të çmimit në mes të LOT 11 'Paracetamol 1000 mg' ku çmimi i ofertuar është 84 centë, ndërsa te LOT 10 për paracetamol 500 mg çmimi i ofertuar është 94 centë.

Pra, për vëllim më të vogël për 500 mg çmimi ka qenë më i lartë për 10 centë.

Ndërsa për LOT-et 1, 2, 6, 13 dhe 15 nuk ka pasur ofertuar fare. Gjithashtu edhe për këto produkte MSh ka thënë se pret që të tenderohet po këtë vit.

"Kemi aktualisht dy aktivitete të prokurimit në procedurë, në njërin nga LOT-et mund të jenë edhe produktet nga këto LOT-et që kanë dështu në këtë tender, por nuk e di saktë produktet me emra⁶⁰."

59 Intervistë më tri menaxheret e kontratave, Fatbardha Murtezi, Arbnore Beka, Burbuqe Salihu dhe zëvendësuesin e udhëheqësit të divizionit të farmacisë, Mentor Sylja, më 18 shtator 2022.

60 Intervistë më Berat Marmullaku, zyrtari i prokurimit në ministrinë e Shëndetësisë, më 7 korrik 2023.

Rekomandimet

Faza e paratenderimit

- 1 Rekomandohet KRPP që të rregulloj procesin e caktimit të komisionit për hartim të specifikacioneve teknike. Komisionet duhet të caktohet bazuar në një vendim.
- 2 KRPP rekomandohet që të bëjë obligative praktikat e iniciuara nga ekipi MSh-së për nënshkrimin e deklaratës nën betim nga ekipit për hartim të specifikimeve teknike.
- 3 KRPP rekomandohet që të monitoroj tenderët që AK i publikojnë me afat të shkurtuar për pranim të ofertave. Pasi që shkurtimi i afateve mund të ndikojë drejtpërdrejtë në numrin e ofertave, është e domosdoshme të ketë një kontroll më të madhe ndaj kësaj praktike.
- 4 AK-të, në veçanti komunat, rekomandohen që të shmangin tenderët me afat të shkurtuar, në rastet kur nuk është me urgjencë një tender.
- 5 AK-të rekomandohen që t'i mbajnë përgjegjës komisionet për hartim të specifikacioneve teknike, nëse konstatohet që ata kanë hartuar kritere diskriminuese apo favorizuese për ndonjë OE.

Faza e tenderimit

- 1 AK-të rekomandohet që t'i anulojnë tenderët dosjet e të cilave pësojnë disa korrigjime të gabimeve që e ndryshojnë në substancë kërkesën e DT apo projektin, për të shmangur zvarritjet e mëtutjeshme me ankesa në OSHP.
- 2 AK-të rekomandohen që të marrin me seriozitet të madh secilën kërkesë për rishqyrtim dhe të njëjtës t'i përgjigjen në secilin pretendim të ngritur.
- 3 AK-të rekomandohet që t'i mbajnë përgjegjës, anëtarët e komisioneve vlerësuese nëse konstatohet që të njëjtit nuk e kanë kryer një punë për të cilën janë ngarkuar, psh. Verifikimi i secilit dokument të OE, krahasimi i tenderëve.
- 4 AK-të duhet t'i shikojnë listat e produkteve që synojnë t'i blejnë në një tender për furnizim dhe duhet të largohen të gjitha produktet që janë të panevojshme ose të përdoren minimalisht. Nëse përdoret metoda e poentimit, produktet që janë më pak të nevojshme duhet të grupohen.

Faza e pas tenderimit

- 1 AK-të duhet të sigurohen që i kryjnë të gjitha punët para-përgatitore përpara se të nisin një projekt, në atë mënyrë që largohen trafot, shtyllat elektrike, bëhen shpronësimet në mënyrë që mos të pengohen punët pas fillimit të zbatimit të kontratës.
- 2 AK-të duhet të lëshojnë referenca negative për kompanitë që vonohen në liferim të barnave, në mënyrë të vazhdueshme.

Ministria e Shendetësisë

- 1 MSh duhet të bëjë një studim fizibiliteti për të parë nëse "Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH)" dhe sisteme të tjera elektronike mund të mirëmbahen edhe nga kompani tjera të specializuara përveç asaj që e ka ndërtuar atë sistem. Kjo është jetike marrë parasysh që ky sistem është i ri dhe do të duhet të mirëmbahet e avancohet në vazhdimësi.
- 2 KRPP duhet të lejojë që dënimet për vonesat në liferim të barnave të jenë më të larta, marrë parasysh që dëmi është i drejtpërdrejtë tek pacientët.

Shtojca 1. Lista e tenderëve të analizuar

1	Sanimi i pendave dhe kanaleve të ujitjes në zona rurale-Kontratë dy vjeçare	Linku	632-22-14081-5-2-1	Para-Tenderimi	Gjakovë	Punë
2	Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë	Linku	632-23-1544-5-2-1	Tenderimi	Gjakovë	Punë
3	Furnizim me material të shtypur zyrtar-Kontratë dy vjeçare	Linku	632-22-13150-1-1-1	Pas tenderimi	Gjakovë	Furnizim
4	Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës	Linku	616-23-781-2-1-1	Para-Tenderimi	Prishtinë	Shërbime
5	Ndërtimi i kolektorit në Hajvali	Linku	616-22-5630-5-1-1	Tenderimi	Prishtinë	Punë
6	Furnizimi me mekanizëm bujqësor për fermer të Komunës së Prishtinës	Linku	616-22-7955-1-2-1	Pas tenderimi	Prishtinë	Furnizim
7	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në sipërfaqe bujqësore	Linku	635-23-1756-5-2-1	Para-Tenderimi	Pejë	Punë
8	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në Rugovë	Linku	635-22-11435-5-1-1	Tenderimi	Pejë	Punë
9	Furnizim me material Hixhenik dhe Ushqimor për nevojat e SHCK-se që nuk janë pjesë të AQP-se	Linku	635-22-11129-1-1-1	Pas tenderimi	Pejë	Furnizim
10	Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe paisjeve rrugore në komunën e Gjilanit	Linku	651-22-10313-2-1-1	Para-Tenderimi	Gjilan	Shërbime
11	Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini - Ri -Ri-Tender	Linku	651-22-7819-5-2-1	Tenderimi	Gjilan	Punë
12	Ndërtimi i Parkut Baja - Ri Tender	Linku	651-22-11519-5-2-1	Pas tenderimi	Gjilan	Punë

13	NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I KANALIZIMEVE FEKALE (GROPA SEPTIKE) NË KOMUNËN E RAHOVECIT	Linku	623-23-179-5-1-1/	Para-Tenderimi	Rahovec	Punë
14	BLERJA E DY AUTOAMBULANCAVE	Linku	623-23-162-1-2-1	Tenderimi	Rahovec	Furnizim
15	NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM	Linku	623-22-6778-5-1-1	Pas tenderimi	Rahovec	Punë
16	Ndërtimi dhe funksionalizimi I QMF Studençan , QMF-Duhël dhe QMF -Gjinoc	Linku	624-23-1039-5-2-1	Para-Tenderimi	Suharekë	Punë
17	Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen Skenderbeu - Suharekë-ritrnder	Linku	624-22-8920-5-1-1	Tenderimi	Suharekë	Punë
18	Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe mirëmbajtja e tyre	Linku	624-22-3252-5-2-1	Pas tenderimi	Suharekë	Punë
19	Hartimi i Projekteve	Linku	644-23-455-2-1-1	Para-Tenderimi	Vushtrri	Shërbime
20	Mirëmbajtja e rrugeve te rendit te katërt.	Linku	644-22-8608-5-2-1	Tenderimi	Vushtrri	Punë
21	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	Linku	644-22-9414-2-2-1	Pas tenderimi	Vushtrri	Shërbime
22	Pastrimi i varrezave dhe sanimi i lapidareve në Komunën e Lipjanit	Linku	613-23-1238-5-2-1	Para-Tenderimi	Lipjan	Shërbime
23	Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush	Linku	613-22-7225-5-1-1	Tenderimi	Lipjan	Punë
24	Renovimi i QMF-se Shalë dhe Magure Faza-II	Linku	613-22-4778-5-2-1	Pas tenderimi	Lipjan	Punë
25	Mirëmbajtja e 70% te HË te SISH-it për Institucionet Shëndetësore	Linku	206-23-1650-2-1-1	Para-Tenderimi	Min Shendetesia	Shërbime
26	RITENDER “ Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”	Linku	206-23-571-2-1-1	Tenderimi	Min Shendetesia	Shërbime
27	Furnizim me barna nga L.E	Linku	206-22-1860-1-1-1	Pas tenderimi	Min Shendetesia	Furnizim

